Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik
Kuvendi i Komunës
-Kryesuesi i Kuvendit-

**01Nr. 60/01-11910/23**
**Kaçanik, 19.05.2023**

**FTESË PËR MBLEDHJE**

Të nderuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës,

Në bazë të nenit 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, e thërras mbledhjen e V (pestë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2023.

Mbledhja do të mbahet në sallën e kuvendit të komunës, në katin e tretë të objektit të komunës, me 30 maj 2023 (e Martë) në ora 11:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Ju mirëpresim!

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

____________________

Në mbledhjen e Kuvendit të Komunës të datës 30.05.2023 do të shqyrtohet ky:

**REND PUNE**

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

2. Draft Plani komunal për Ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në komunën e Kaçanikut, 2023-2025;

3. Propozim Vendimi për Shfuqizimin e Vendimit 01Nr. 104/02-7676/22 për dhënien në menaxhim të përkohshëm parkingjet në pronësi të komunës, ndërmarrjes publike KRM " Pastërtia, Sh. A- Njësia në Kaçanik;

4. Propozim Vendimi për Emërimin e komisionit përzgjedhës për Drejtor të institucioneve arsimore;

5. Propozim Vendimi për shpallje me interes publik pjesën e PK 00382-2 ZK Bajnicë, në emër të Xhemal Fazli, për këmbim me pjesët e parcelave 00379-0; 00384-0, pronë shoqërore rrugë publike;

6. Propozim Vendimi për shpallje me interes publik pjesën e PK 00439-1, ZK Duraj, në emër të Adem Salihaj, për këmbim me pjesën e parcelës 00452-0, pronë shoqërore rrugë publike;

7. Propozim Vendimi për shpallje me interes publik pjesën e PK 00905-2, ZK Nikaj, në emër të Fatmir Gula, për këmbim me pjesën e parcelës 00920-1, pronë shoqërore rrugë publike;

8. Propozim Vendimi për shpallje me interes publik pjesët e PK 00980-0; 00982-0, ZK Kaçanik në emër të Naser Dema, për këmbim me PK 00979-0, pronë komunale;

9. Propozim Vendim për caktimin e lokacionit për nevoja të HANDIKOS;

10. Raporti i punës i Komitetit për Komunitete për vitin 2022.

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova**
**Republic of Kosovo**

**Komuna e Kaçanikut**
**Opština Kacanik**
**Municipal of Kacanik**

**01Nr.60/01-9199/23**
**Kaçanik, 28.04.2023**

**PROCESVERBAL**

Nga mbledhja e **IV(katërt)** e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2023 (Legjislatura e shtatë), mbajtur me 28 prill 2023. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.
Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin fillimisht 26 anëtarë, në ndërkohë -në fillim të pikës së dytë, arriti edhe anëtari Betim Shala, kështu që konstatohet se prezentë ishin 27 anëtarët - të gjithë.
Nga Ekzekutivit i Komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Nënkryetari i Komunës- Sabedin Vishi**,** Drejtorët e drejtorive: Bahri Selimi-DBF, Ramadush Osmani-DSHPE, Qamil Stagova- DUKMM, Suhad Dullovi- DBPZHR, Dardana Tafili-Dauti-DAP, Pranvera Loku-Zharku- DZHET, ndërkaq nga zyrtarët e komunës në kuadër të detyrave të punës ishte Bejtulla Dalloshi, ndërkaq pati edhe zyrtar tjerë komunal.

Nga strukturat vendore mbledhja monitorohet përmes Teleprezencës nga Gëzim Sahiti- zyrtar i lartë për monitorim të komunave në MAPL. Mbledhja ka transmetim të drejtpërdrejtë.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli- Kryesues i Kuvendit
Procesmbajtës, Makfire Malsiu.

**Kryesuesi i Kuvendit z. Kemal Murseli:** Të nderuar pjesëmarrës, së pari iu përshëndes të gjithëve, iu dëshiroj mirëseardhje, konstatoj kuorumin, prezentë për momentin janë 26 anëtarë. Kushte pune me u mbajt mbledhja ka, e hapi mbledhjen e IV (katërt) të rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2023, data 28 prill, me këtë:

**REND PUNE**

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Raporti tre mujor financiar, Janar-Mars 2023;
3. Propozim Vendimi për Transferin e mjeteve nga Rezerva komunale sipas buxhetit të vitit 2023;
4. Propozim Vendimi për Transfer dhe Rialokim te mjeteve buxhetore;
5. Propozim Vendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e PK nr.00516-1 ZK Kaçanik, për rregullimin e rrugës dhe ndërtimin e urës mbi lumin nerodime;
6. Propozim Vendimi për Shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesë të Parcelave kadastrale 00431-5, 00431-6, 00431-7; 00411-0 në ZK Duraj, për Këmbim me pronën komunale.

Lidhur me rendin e propozuar të punës, e hapi diskutim: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë, Rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës,

**APROVOJ**

**Rendin e punës në përbërje prej 6 pikave.**

U kalua në shqyrtimin e pikëve sipas renditjes:

**1.** Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës;
Vërejtjen e në Procesverbal paraqiti z. Adnan Reka: Në f. 1, ku thuhet se kjo mbledhje për shkaqe teknike nuk ka mundur të transmetohet drejtpërdrejtë, "kjo mbledhje nuk është regjistruar (incizuar), nuk është monitoruar përmes teleprezencës, dhe nuk është emetuar fare". Të pika 2, diskutimi im ka dallime të theksuara në formulim dhe përmbajtje. Diskutimin e kam të shënuar me shkrim dhe mundem t'ia përcjellë zyrtares së KK.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Procesverbali i mbledhjes së kaluar të KK e shtroj në votim për aprovim me vërejtjet e Adnan Reka dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës,

**APROVOJ**

**Procesverbalin e mbledhjes së III (tretë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik, të datës 31.03.2023 / Lënda: 01Nr.60/01-7162/23.**
Procesverbali do të publikohet i korrigjuar.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Kalojmë në pozicionin e Pyetjeve dhe Kërkesave:

**Pyetje dhe Kërkesa**

**znj. Ardita Rrahmani:** Kërkesa ime ka të bëjë me shkollën "Ali Asllani" objekti i vjetër ku zhvillohet mësimi. Ka katër(4) vite që ka filluar ndërtimi i objektit të ri, ndërkaq nxënësit e asaj shkolle të atij lokaliteti mbi 300 nxënës janë të detyruar me mbajtur mësim në atë shkollë në kushte të mjerueshme, ku bien edhe krimba mbi banka nga tavani i shkollës së vjetër.
Mungesa e një aparati fotokopjues apo printeri, sjellë pengesa në realizimin e orës së planifikuar. Mungesa e inventarit edhe në sallën e arsimtarëve, është problem në veti. Pyetja ime është: Kur do të përfundoj objekti i ri shkollor, dhe a ka kush që e merr përgjegjësinë për gjendjen e objektit të vjetër të shkollës në atë lokalitet?
**znj. Kadrije Lika-Troni:** Për shkak të keq menaxhimit dhe projektimit të dobët të hapësirave publike, ose me shumë edhe nga mosdija, nga hyrja e qytetit e deri të komuna për të vazhduar me bulevardin "Ismajl Raka" e deri të shtëpia e kulturës mbizotërojnë muret me gurë, duke mos anashkaluar edhe projektin e fundit të shëtitores për gjatë lumit nerodime. Aq shumë është uzurpuar qyteti nga punimet prej guri, saqë kalaja me të cilën identifikohet qyteti ynë, ka mbetur e zbehur karshi tyre, saqë gati nuk duket fare. Ju, ose keni qenë shumë të frymëzuar nga kalaja që është e ndërtuar me gurë, saqë të gjitha projektet në hapësirat publike i keni filluar dhe përfunduar me gurë. Në vend se qyteti ynë të jetë një qytet i luleve e trëndafilave, i keni dhënë vlerë gurit e murit. Edhe ato pak hapësira gjelbëruese që ka komuna jonë, nuk janë të mbjella dhe të zbukuruara me ndonjë lule. Si është e mundur që asnjë lule të mos mbjellët në hapësirat gjelbëruese, ku qëndron problemi këtu ? Prandaj, për ju kryetar kam dy pyetje:

1. A ka komuna projekt për mirëmbajtjen e hapësirave publike, konkretisht hapësirave të gjelbra, në kuadër të te cilave do të mbjellën lule?
2. A ka komuna të kontraktuar ndonjë lulishte për t'i kryer këto punime, ose a planifikon në të ardhmen të këtë ndonjë projekt të tillë?

**z. Agim Mani:** Të projekti i rregullimit dhe asfaltimi i rrugëve në zona rurale në Kaçanik, cilat pjesë të rrugës kanë me u rregulluar dhe asfaltuar me këtë projekt ? Kërkoj nga DUKMM për

secilin projekt që është në kuadër të këtij projekti, t 'na jep veç e veç emrin e secilit projekt, për shkak se ju i keni futur me një kod buxhetor të gjitha projektet që kanë të bëjnë me këtë projekt, ndërsa ne si anëtarë të KK nëse na pyesin qytetarët, nuk i dimë projektet që hynë në këtë kod buxhetor.

**z. Naim Beça:** E kam një pyetje të shkurtër: Në mbledhjen e kaluar të KK e kemi pasur një problem për çështjen e hekurudhës në Kaçanik, ku kemi shprehur shumë pakënaqësi. Shumica e anëtarëve të kuvendit me të cilët kam pasur kontakt, janë pajtuar me mendimet tona. A ka diçka të re rreth asaj procedure që është duke ndodhur, për çështjen e mbikalimeve, nënkalimit hekurudhor, a janë biseduar me ministrinë këto çështje?

**z. Agim Çaka:** Unë për këtë mbledhje kam këto pyetje;
1. Në seancat e kaluara kemi kërkuar një Raport të detajuar lidhur me pronat e dhëna në shfrytëzim nga komuna, në mënyrë që ne si anëtarë të KK, të njoftojmë qytetarët lidhur me dinamikat e investimeve, seriozitetin dhe arsyet e atyre pronave komunale të dhëna në shfrytëzim.
2. Gjithashtu na është premtuar që do të sillet një, Raport i detajuar lidhur me objektin social në Kaçanik të Vjetër. Kur ka nisur punimet ky objekt, sa ka qenë afati i zgjatjes së punimeve, sa ka qenë kostoja e ndërtimit të këtij objekti, sa ka qenë shuma e participimit të komunës dhe sa e qeverisë, sa është shuma e mjeteve të shpenzuara për këtë projekt jashtë asaj që është planifikuar, kur pritet përfundimi definitiv dhe lëshimi i këtij projekti objekti ?
3. Për sa janë ndaluar punimet aq sa kam parë unë, në disa prej projekteve të cilat ka kohë që kanë filluar dhe nuk po dihet se kur do të përfundojnë? Momentalisht nuk po e shoh se po zhvillohen pune në Çarshinë e qytetit, Sheshin e qytetit, Stadiumin- projekt ky i cili është pa përfunduar, Projekti i varrezat të dëshmorëve është i papërfunduar, Terrenet ndihmëse të halla e sporteve nuk ka punime atje, e mos të flasim për disa investime të vogla të cilat duhet bëhen në qytet, e si duket nuk ka interesim e as vullnet për intervenim ndaj këtyre projekteve të cilat janë ngritur si shqetësim edhe në seancat e kaluara.
4. Ku kemi arritur me PZHK, a janë kryer diskutimet publike sipas planifikimeve, dhe kur presim që ky plan i ri zhvillimor të miratohet?

**z. Bashkim Luma:** Në pyetjen lidhur me mungesën e kuadrit profesional, në shkollën e f. Glloboçicë, nga drejtoria e Arsimit, nuk kam marrë përgjigje.
2. Në përgjigjet e dhëna nga DSHPE, e shoh se ka shumë kontradikta këtu. Unë e di se totali në rrugën " Batalioni III " është shtruar nga ministria, atëherë kur është bërë rruga: Gorancë-Glloboçicë, si projekt ndër komunal.
3. Tjetra që vlen të cekët: Operatori ekonomik ka periudhë një vjeçare të garantimit të punëve të kryera. Pse atëherë nuk po sanohen ato probleme të cilat janë krijuar gjatë rregullimit të kanalizimit?
4.Pyetje për Nënkryetarin: Në manifestim sa ishte prezentë gjatë mbajtjes se fjalimit, nënkryetari tha se shkollat tona kanë kushte evropiane. A mund të konsiderohen kushte evropiane në një shkollë kur ka mungesë të laboratorëve, kabineteve e lërë me mungesë të bibliotekës në shkollë ?

**z. Adnan Reka:** Unë e kam një pyetje për zyrtarin e IT, Bejtulla Dalloshi, lidhur me deklarimin e pasurisë. Unë e kuptova para mbledhjes, por e kam për të tjerët, se ka paqartësi se a duhet të deklarojmë pasurinë për së dyti apo vlen deklarimi që e kemi bërë në muajin mars 2023 ?

**z. Bejtulla Dalloshi:** Jo nuk ka nevojë me deklaruar më pasurinë për së dyti, edhe pse iu vijnë mesazhe. Pasurinë të cilën e keni deklaruar në muajin mars (01-31 mars 2023) është në rregull ai deklarim.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Pyetje dhe Kërkesa tjera nuk ka, atëherë kalojmë në pikën e dytë:

**2.**Raporti tre mujor financiar, Janar-Mars 2023;

Materialin e keni marrë, Raporti është shqyrtuar edhe në KPF, drejtori është këtu, e hapi diskutimin:

**z. Agim Mani:** Ky raport pasqyron, planifikimin, realizimin e buxhetit të vitit 2023 për këtë periudhë tre mujore. Komuna e Kaçanikut në vitin 2023 e ka pasur një buxhet me të madh sesa herëve tjera, mirëpo ky buxhet nuk ka arritur të realizohet në mënyrë konsistente, ashtu si është planifikuar. Fjala vjen, të te HVK, planifikimi i përgjithshëm ka qenë 862,578€, ndërkaq janë inkasuar 127, 365€, vetëm 14.77%, ndërkaq është dashur realizimi i inkasimit të jetë 25%. Shpenzimet e realizuara në total janë 15.35%, kur dihet që në këtë shumë kanë hyrë edhe pagat dhe mëditjet të cilat janë realizuar %% se ato janë edhe obligative, ndërkaq shqetësuese është fakti i realizimit të shpenzimeve të investimeve kapitale, realizim ky i cili prekë me së tepërmi interesat e qytetarëve. Shpenzimet kapitale janë realizuar vetëm 2.6%, këtu preken interesat e qytetarëve, ndërkaq me këto shpenzime rregullohet edhe mirëqenia e qytetarëve. 3.76% janë realizuar shpenzime të subvencionet dhe transferet, e që ky realizim është i dobët. Shpenzimet tjera të mallrat dhe shërbimet, paraqitur edhe në tabela, disa janë të pakuptueshme, se është bërë një përmbledhje e përgjithshme e tyre, si shpenzimet me përfaqësimin e avokaturës, 531€, shërbimet e ndryshme intelektuale ku keni paguar shërbime këshilluese, 520€, 570€. Shpenzimet teknike, pyetje për drejtorin: Çka janë këto shpenzime teknike, ku në këtë tre mujor janë shpenzuar 31,0.59€. Në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, që janë shpenzuar vetëm 320€, kurse diferenca është 30,000€. Çka keni përmbledhur në këto shërbime teknike, në cilin kod buxhetor apo në çfarë projekti i keni realizuar këto shpenzime teknike. Për dru thuhet se i keni shpenzuar 3,098€. Tenderi është hapur në dhjetor për furnizim me dru, cila ka qenë arsyeja me blerë dru përsëri, kur dihet se tenderi ka qenë 2 vjeçare, ndërkaq ende pa i bërë 2 vjet është hapur tenderi tjetër, dhe ne tre mujorin e parë janë shpenzuar mbi 3,000€ dru. Të mirëmbajtja e rrugëve lokale janë shpenzuar 63.254€, ndërkaq ne e dimë se në këtë vit nuk ka pasur borë fare, ndërkaq është absurde me u shpenzuar këto mjete. Shpenzimet për vendime të gjykatave, 3,800€. Pyetje për drejtorin, tremujorin i parë TM1 Dhe TM2 i keni saktësuar dhe paraqitur vlerat, nga e keni nxjerrë përqindjen e totalit. A pasqyron përqindja e realizimit TM1 dhe TM2 të rubrika e parafundit, se nëse keni nxjerrë përqindjen nga viti në vit, nuk del kjo përqindje. Të shpenzimet komunale në KPF i kemi diskutuar disa gabime, të cilat i keni përmirësuar me vonë, ndërsa kanë mbetur pa u përmirësuar shpenzimet komunale në total të TM1 2023 dhe keni shkuar TM2 2022. Edhe kjo duhet të përmirësohet se është raport ky dhe mbetet në këtë formë. Të subvencionet dhe transferet, 3.7% janë realizuar, e që shumë pak mjetet të shpenzuara.

**z. Agim Çaka:** Një pyetje për drejtorin lidhur me raportin financiar: Unë nuk e kam të qartë inkasimin e realizuar të vitit 2022, sepse sipas raportit del se janë inkasuar 7,754 € me pak mjete. A është fjala për vitin 2022 ? Kjo shumë është e inkasuar me pak se në tre mujorin e vitit të kaluar. Tani a është inkasimi me i madh apo me i vogël? Cilat janë shkaqet e inkasimit me të vogël ? Se po del që inkasimi është me i dobët, ndërkaq shpenzimet janë me të mëdha. Kjo në matematikën financiare nuk është bash e qëndrueshme.

**z. Rrustem Zenuni:** Parafolësi e tha se shqetësimin tim. E pyes drejtorin se a jeni munduar me i nxjerrë shkaktarët për rënin e inkasimit të tatimit në pronë?

**z. Bahri Selimi:** Po kyçem në këto pyetjet të cilat u ngritën. Shqetësimi me i madh mbetet të hyrat nga tatimi në pronë, pyetjet që i bënë Agim Mani dhe Agim Çaka. Të te hyrat, kuartali parashihet realizimi 25%, ndërkaq realizimi është afër 16%. E vetmja e hyrë që ka pësuar rënie, është tatimi në pronë dhe tatimi në tokë. Të gjithë e dimë se sivjet është nisur keq me TP nga MEF, është bërë njëherë një rivlerësim i pronave, me çka u çrregullua situata, pastaj u lajmërua falja e borgjeve nga 100€ për secilin tatim pagues. Kjo deklaratë e ministrit të financave ka ndikuar që qytetaret të hezitojnë me paguar TP dhe ende nuk e kanë të qartë se çka po ndodhë.

Projektligji për faljen e borgjeve është në proces, ka pyetje të shumta prej qytetarëve, ndërkaq me 30 prill është data e fundit për pagesën e këstit I-r. Në të njëjtën kohë qytetarët kanë me u ndëshkuar për interes për mos pagesë, ndërkaq në anën tjetër ka proklamim nga ministria se ka me u hequr ngarkesa e këtij viti, në përgjithësi nuk kemi shumë përgjigje të pagesës dhe kemi rënie të TP si në çdo komunë. Faji dihet, kjo rënie ka ndikuar në të gjitha komunat në mosrealizim me kohë të investimet kapitale, se TP alokohet %% destinohen në investime kapitale. Kjo ndikon në ngecje të alokimit direkt të projektet kapitale të planifikuara me buxhet. Shpenzimet e investimeve kapitale, krahasuar me tre mujorin e parë të vitit të kaluar, nuk del se kemi rënie, por del se janë shpenzuar me tepër mjete, kjo nuk është e mjaftueshme, por si komunë shquhemi se nuk hyjmë në borgje. Secila komunë që ka shpenzime të konsiderueshme të investime kapitale, del se kanë paguar obligimet e vitit të kaluar. Ne nuk kemi pasur obligime, ndërkaq shpenzimi afër 8,000€ ka të bëjë me një shpronësim. Në vitin e kaluar kemi pasur të shpronësimet 1,924€, por nuk është periudhë që shquhet për shpenzime të IK. Të shpenzimi total, është karakterizuar ky shpenzim pak me i lartë, pasi pagat e muajit shkurt dhe mars kanë ardhur me ngritje sipas Ligjit për pagat në sektorin publik,94.000€ për komunën tonë është kostoja shtesë, ndërkaq programet shpenzuese tjera buxhetore kanë shkuar gati njëjtë. Të analitika e mallrave dhe shërbimeve, të shërbimet intelektuale, nuk është se kemi paguar ndonjë intelektual ndonjë zyre këshilluese, këtu hyjnë shpenzimet e komiteteve; komitetit të auditimit, komiteti për komunitete, që janë paguar nga 50€ nga ky kod, shpenzimet e avokaturës kanë të bëjnë me përmbaruesit privat për disa obligime të tatimpaguesve. Të drutë nuk e kam të qartë, ndoshta është paguar ndonjë obligim i vitit të kaluar, kontrata është e hapur është shumëvjeçare. Të mirëmbajtja e rrugëve lokale, janë shpenzuar 63,254€, borë nuk ka pasur, por reshje shiu ka pasur, aty nuk hynë vetëm pastrimi i borës, por edhe i reshjeve të ndryshme atmosferike, por për me ditur a është kosto reale e krahasojmë me vitin e kaluar të njëjtën periudhë. Shumën 86,282€ e kemi pasur në vitin e kaluar krahasimi me të njëjtën periudhë, tani e kemi 63,254€, kështu po përputhet diferenca për 23,000€ me pak. Përgjigje mundet me u kthyer tani edhe drejtori i DESHP. Në vazhdim drejtori i financave dha edhe sqarime tjera të cilat u ngritën.

**z. Agim Mani:** Drejtor, unë e pashë që fokusin me të madh e pate të çështja e tatimit, d.m.th. deshtë me devijuar fjalën. Nëse e marrim një krahasim të HVK të vitit 2022 në vitin 2023 ka pasur me tepër të hyra përveç TP që e përmende. Në vitin 2022 i kemi 162,000€, ndërkaq në vitin 2023 janë inkasuar me tepër mjete, d.m.th. nuk është dallimi shumë i madh. Nga e keni nxjerrë përqindjen, është dashur me shënuar këtu se për cilin vit e keni nxjerrë përqindjen?

**z. Bahri Selimi:** Përqindjen e kemi nxjerrë nga shpenzimi total. Secili kod i shpenzimit është shënuar sesa ka marrë pjesë në shpenzime, dhe është nxjerrë totali i shpenzimeve.

**z. Selajdin Troni:** Desha me i bërë pyetje drejtorit të financave, por këtë herë pyetjen po ia adresoj z. Agim Manit: A duhet me paguar tatimin në pronë apo jo, sepse fatura me ka ardhur ?

**z. Agim Mani:** Pasi je nga familja e dëshmorëve, unë ju kisha liruar nga pagesa e tatimit në pronë.

**z. Selajdin Troni:** Unë nuk jam përfaqësues i familjeve të dëshmorëve, unë nuk kam dëshirë me u përmend këto çështje këtu, se unë jam këtu në KK përfaqësues i një partie politike. Unë i përfaqësoj këtu interesat e qytetarëve, ndërkaq përfaqësues të familjeve të dëshmorëve, veteranëve, janë shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Secili që e merrni fjalën, përfundoni diskutimin deri në fund, se diskutimi në formë interaktive është problem për zyrtaren e KK me mbajtur proces. Nuk ka nevojë me diskutuar asnjë grup politik këtu duke akuzuar apo lavdëruar qeverinë për vendimet e saj. Ne jemi nivel lokal dhe flasim për interesat e brendshme të komunës tonë, kështu që këtë praktikë të heqim nga KK, sepse vetëm po na e zgjasin debatin.

**z. Naim Beça:** Parashtroj pyetje për çështjen e tatimit në pronë: A është e përcaktuar me ligj ndëshkimet nëse nuk e paguajmë faturën e tatimin në pronë? Cilat janë masat që munden me u marrë, se edhe unë kam do obligime të pa paguara, kështu që dua me ditur cilat janë pasojat, nëse nuk e paguaj tatimin në pronë ?

**z. Bahri Selimi:** Për mos pagesë të këstit të parë, e keni pa njoftimin e Departamentit të tatimit në pronë, ku është bërë thirrje nga ministria për me paguar TP, është 0.65% interes dhe 10 % të mos pagesës, kjo është me ligj e përcaktuar. Në të njëjtën kohë e kemi në procedurë projekt ligjin, por ai ende nuk është bërë ligj. Kur të bëhet ligj dhe kur të falet pagesa vjetore, ndëshkimi nuk falet për mos pagesën e tatimit në pronë.

**z. Rrustem Zenuni:** Po ndërlidhem me diskutimin e mëhershëm. Ju kërkuat që mos me i komentuar vendimet e qeverisë, mirëpo ato vendime po na shkaktojnë probleme, ky është problemi që po i shprehim shqetësimet tona.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Për një vendim që nuk na duket i mirë, nuk i ka fajet Agimi. Prandaj ju nuk keni nevojë me drejtuar gishtin tek anëtarët e KK për vendimet që dikush tjetër është vendimmarrës, unë të gjithëve këtu po iu themi, jo vetëm juve.

**z. Rrustem Zenuni:** Unë e drejtoj gishtin kah anëtarët e KK të cilët e mbrojnë vendimin e qeverisë, ndërkaq unë i përkrahi vendimet e qeverisë. Unë nuk i themi Agimit apo Adnanit se ju jeni fajtor. Vendimi i qeverisë për me hequr taksën për regjistri të veturave, për pagesën e TP ka shkaktuar problem të te HVK, me çka i ka ulur të HVK, kështu që e kam të pamundur mos me fol për këtë çështje, se kjo ka qenë e qëllimshme. Në njërën anë ngritët vlera e TP, në anën tjetër po ua falim nga 100 € çdo tatuesit në pronë. Unë e kam të pamundur mos me komentuar se na ka shkaktuar problem kjo çështje.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Kuvendet komunale funksionojnë sipas ligjeve në fuqi. Ne mund t'i komentojmë ligjet, por nuk jemi ne ata të cilët i marrim ligjet. Ne diskutojmë këtu për kompetencat të cilat i kemi si komunë dhe për vendimet të cilat i marrim këtu, ndërkaq ligjet i zbatojmë pavarësisht a janë të mira apo të këqija.

**z. Selajdin Troni:** Pyetje për drejtorin lidhur me tatimit në pronë: Lidhur me faturat i kemi marrë të tatimit në pronë, a duhet me paguar tatimin në pronë apo jo?

**z. Bahri Selimi:** Për ata të cilët paguajnë sivjet, nëse ligji aprovohet, shuma që e paguan sivjet, rimbursohet në vitin vijues.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, Raporti financiar kalon si informatë, kështu që konstatohet se Kuvendi i Komunës,

**NJOFTOHET**

**Me Raportin tre mujor financiar, Janar-Mars 2023/ Lënda: 01Nr. 60/01-9256/23.**

**3.** Propozim Vendimi për Transferin e mjeteve nga Rezerva komunale sipas buxhetit të vitit 2023;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Fjalën e ka drejtori i DBF, Bahri Selimi, për sqarime të nevojshme:

**z. Bahri Selimi:** Nuk është hera e parë që marrim vendim për transferin e rezervave komunale. Shumat të kategoria ekonomike e shpenzimeve kanë lëvizur pa u zvogëluar apo rritur buxheti. Shuma e rezervës është 120,000€, e cila vjen si rezultat i asaj që ne si ekzekutiv nuk kemi arritur me i specifikuar në detaje me i definuar projektet ashtu si i kërkon ministria nuk i kemi definuar mirë, kështu ministria e cilëson si rezervë deri sa ne t'i plotësojmë kushtet tamam t'i definojmë kushtet me emër specifik të projektit. Ne e kemi adresuar propozim vendimin në

KK, por jo me shumën 120,000€, por në shumën 70,000€, se 50,000€ i takojnë shëndetësisë dhe kjo drejtori është ende duke i shqyrtuar politikat e saj se ku me i shpenzuar ato mjete. Ndërkaq shumën 70,000€ e kemi paraqitur në detaje se ku do i shpenzojmë. Pika 1 ka të bëjë me mbetjet e mjeteve nga GQ të projekteve, ku janë sqaruar kodet nga merren dhe në cilin kod transferohen. Të pika 2, kemi të bëjmë me rezervën nga të HVK, transferi bëhet aty ku e kemi parë të nevojshme. Kjo pikë dhe pika në vijim ndërlidhen me bartjen e të HVK të vitit 2021 të cilat mjete edhe pse është marrë vendim në KK nuk ka kaluar në qeveri, 319,000€ apo diku 40% e vendimit nuk është aprovuar, është aprovuar vetëm bartja e të HVK të vitit 2022, që i vjen diku 60% e vendimit. Ne jemi detyruar që rezervën me dërguar një pjesë të projektet që i kemi paraparë me bartje, pasi që ministria për momentin nuk i ka bllokuar ato mjete. Mjetet transferohen, të projektet: Në arsim, ndërtimin e kulmit të SHF "Qamil Ilazi, të planifikimi urban janë të ndërtimi i rrugëve urbane, dhe të kultura. Projektet janë të qëlluara, këto mjete e kemi pasur ndërmend me i orientuar diku tjetër, por plani ka devijuar, nga refuzimi i ministrisë së financave për bartjen e mjeteve të vitit 2021, e që kjo nuk ka ndodhë asnjëherë me na i stopuar mjetet. Ne si komunë edhe komunat tjera edhe AKK, mendojmë se në mënyrë të jashtëligjshme ministria na i ka bllokuar këto mjete, se ka mënyra tjera me ngritur përformancën. Ministria munden me stopuar GQ dhe me ua ndërruar destinimin, por jo të HVK. Arsyetohen nëse i marrin të HVK për ndonjë qëllim emergjent për fond shëndetësor, situata të krizës apo të ngjashme, ne kishim bërë kursimet dhe kishim marrë vendim këtu si KK, por kur e dimë përformancën që është tepër e ulët e qeverisë dhe ministrisë, se as ata vet nuk munden me shfrytëzuar GQ, ndërkaq në anën tjetër bllokohen të HVK të taksapaguesve tonë, nuk është në rregull.
**z. Agim Mani:** U tha me herët drejtor që mos me kaluar në kompetenca të ministrisë, por këtë që po thoni ju, në arsyetimin e juaj lidhur me të HVK është e padrejtë. Ju keni bërë bartje të HVK nga viti në vit. Fjala vjen për vitin 2021 keni bartur shumën mbi 300,000€, ndërkaq ka qenë nevojat e mëdha të komuniteteve për projekte, ndërkaq nuk i keni realizuar. Një fakt duhet me pranuar që, mjetet i keni pasur, gjithashtu kanë ekzistuar edhe projektet, ndërkaq nuk i keni realizuar. Kjo shumë e mjeteve që po transferohet në kodet buxhetore nga rezervat komunale, shuma 70,000€ dhe 50,000€ të shëndetësia, shuma prej 50,000€ të shëndetësia, a janë ende në rezervë apo kanë kaluar? Bartja e këtyre mjeteve është mirë të saktësohet se ku po shkojnë. Në disa kode janë caktuar shumat nga 5,000€, ndërkaq shuma 20,000€ të transferohen nga nën programi buxhetor 17528 kodi funksional 0112 në nën programin buxhetor, planifikimi urban dhe inspekcioni 66445 kodi funksional 0620 në kategorinë, rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve në pjesën rurale në Kaçanik, me u specifikuar me emër secila rrugë që ka me u rregulluar e asfaltuar.
**z. Bahri Selimi:** Momentalisht të koduar e kemi projektin 53198, rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve në pjesën rurale në Kaçanik. Me vonë DUKMM iu jep transparencë se në cilat rrugë kanë shkuar mjetet, se ka shumë rrugë të cilat janë shumë të shkurtra, të cilat me i ndarë me kode të veçanta kur të aprovojmë buxhetin, bëhet lista shumë e gjatë. Ministria e lejon këtë formë, sepse rrugët që janë shumë të shkurtra nuk munden me marrë emër specifik. Edhe komunës i lejohet me pasur një farë fleksibiliteti, sepse nuk mundet 100% projektet që janë shumë të vogla (imta), por që karakterizohen me vlerën mbi 1000€ të grumbullohen në një kod buxhetor, siç është ky kodi 53198 rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve në pjesën rurale në Kaçanik. E kemi edhe një kod tjetër në zonën urbane, pasi që në qytet mundet me ndodhë me u shtruar në rrugicë, apo me intervenuar komuna për ndonjë prishje të trotuarit, rrugës etj. nga vërshimet apo të ngjashme. Këto projekte, kur të realizohen, DUKMM e bënë listën dhe e raporton se në cilat projekte kanë shkuar mjetet.

**z. Naim Beça:** Kush vendosë për rrugët e shkurtra që e potencove drejtor se janë me një kod buxhetor, a vendosin 2-3 persona apo kush vendosë? Pse nuk bëhen kodet buxhetore për secilën rrugicë?

**z. Bahri Selimi:** Të Zyra e kryetarit, DUKMM dhe të DSHPE çdo ditë vijnë kërkesa të ndryshme për prioritete. Ato që janë me të nevojshme dhe me të domosdoshme iu japim

prioritet dhe i financojmë. Ne vendosim si ekzekutiv i komunës se cilave projekte me iu dhënë prioritet.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim këtë pikë. Rezultati i votimit, me 15 votë për, Kundër votë 7 nga LVV Abstenime 4 votë (dhe 3 anëtarë nga LDK Raif Kasa nga LVV) Prezentë 26. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

**VENDIM**

**Për Transferin e mjeteve nga Rezerva komunale sipas buxhetit të vitit 2023 /01Nr. 400/03-9058/23.**

**4.** Propozim Vendimi për Transfer dhe Rialokim te mjeteve buxhetore;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Materialin e keni marrë, para se me hapur diskutimin, fjalën e ka drejtori i DBF, Bahri Selimi:
**z. Bahri Selimi:** Edhe kjo pikë e rendit të punës vjen si rezultat i mos bartjes se mjeteve buxhetore nga vitet paraprake. Kemi qenë të detyruar me bërë një version tjetër, janë diku mbi 200,000€ që barten, ashtu që disa kode buxhetore mos të rrinë pasiv, me orientuar mjetet. Kontratat veç ekzistojnë, janë 3 vjeçare, janë projekte të qëlluara dhe të detajuara mirë, të njëjtat presin me u bërë me buxhet me u realizuar gjatë këtij viti.

**Kryesuesi i Kuvendit:** E hapi diskutimin:

**z. Agim Mani:** Edhe të kjo pikë e rendit të punës mund të themi që ka keq planifikim të mëhershme, se miratimi i buxhetit kur është bërë ka pasur shumë kode buxhetore për këto projekte, të cilat i kemi kundërshtuar ne në atë kohë. Arsyeja ka qenë se ne e kemi ditur se ministria nuk investon në kode buxhetore. Ministria bashkë financon në kode buxhetore të reja. Ju keni paraqitur shumë kode buxhetore, ndërkaq nuk i keni realizuar asnjë. Të planifikimi urban, ndërtimi i urës mbi lumin nerodime, mbi hekurudhë, pika 5.3 kanë qenë të koduara 5,000€, ndërkaq tani po i bartni mjetet. Në mbledhjen vijuese kemi me pasur pikë, shpronësimin e pronës për ndërtimin e urës. Këtë kod ju po e fshini. Çështja është se, a duhet të bëhet kod i ri për këtë projekt ? Të projekti, Rregullimi dhe asfaltimi i rrugës Gërlicë-Stagovë- Kaçanik i Vjetër, ne e dimë që në vitin e kaluar kjo rrugë ka qenë me këtë kod buxhetor. Kjo rrugë ka kaluar disa procedura të tenderimit, ndërkaq në OSHP është rrëzuar për shkak të keqpërdorimit të prokurimit, përsëri në vitin 2023 e keni futur si kod, ndërkaq pa e përfunduar rrugën e hiqni këtë kod, se nuk e keni prioritet më këtë rrugë me shtruar.

**znj. Ardita Rrahmani:** Krahasuar me komunat tjera, si komunë i kemi 814,000€ të cilat i kemi bartë në mbledhjen e kaluar, të cilat mjete kur të barten kalojnë në buxhetin vjetor të një viti. Nuk janë shumë mjete krahasuar me komunat tjera, është një shumë e mjaftueshme ku janë investimet direkt të qytetarëve të komunës, duke ditur sa vend i vogël dhe i varfër është komuna jonë. LDK në këtë rast i ka meritat në Kuvendin e Kosovës për bartjen e këtyre mjeteve. Sot besoj se do të votohen këto projekte që u janë dhënë prioritet me u realizuar. Unë nuk e kam të qartë projektet e propozuara duke i krahasuar me ato të cilat i votuam në mbledhjen e kaluar. Këtë po e themi se janë 15 projekte të cilat i kemi votuar në mbledhjen e kaluar. Në nëntë (9) projekte të cilat janë propozuar me u votuar sot, përpos gabimeve teknike, për mua po krijojnë një amulli. Këtë po e themi se, në mbledhjen e kaluar kemi votuar, ndërtimin e objektit të QMF në f. Doganaj faza e tretë e projektit. Sa kam informata unë, mund të mos jenë të sakta, ajo fazë nuk ka përfunduar, ndërkaq në propozim vendim thuhet për rindërtimin e objektit të QMF në Doganaj të Kaçanikut. Është vlera e njëjtë, kodi i njëjtë, ndërkaq në fjali ka diskrepancë. Tjetra, në mbledhjen e kaluar e kemi votuar me kod të ri të projektit, kurse në propozimin e sotëm nuk parashihet si kod i ri. Kurse për me bërë një krahasim të projekti i ndërtimit të nënkalimit për këmbësor nën hekurudhë, edhe në seancën e kaluar edhe sot, shihet se është kod i ri. Besoj se drejtori e ka të qartë se për çka e kam fjalën. Janë gjashtë (6) projekte të cilat janë hequr, për

të cilat i ka dhënë arsyet drejtori në KPF edhe sot. Pyetje: Kryetar këtyre gjashtë (6) projekteve të cilat i keni hequr, kur keni me iu dhënë prioritet, të cilat i kemi votuar në muajin e kaluar, se problemet që i keni me qeverinë, nuk me interesojnë mua fare?!

**Kryetari i Komunës:** Ne, në fillim kemi thënë se jemi falënderues për deputetet e LDK që e kanë iniciuar këtë çështje, mirëpo nga debatet që i kemi dëgjuar të pozitës kohëve të fundit, është thënë se LDK nuk ka ditur me i lexuar.

**znj. Ardita Rrahmani:** Unë i përcjelli seancat e Kuvendit të Kosovës. LDK ka ditur me i lexuar çështjet, po të mos kishte ngritur këto çështje LDK, këto projekte nuk kishim pasur mundësi me i realizuar.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ne vendimin e kemi marrë në mbledhjen e kaluar për bartje të mjeteve, vendimi donë zbatim. Vendimi është dërguar në MAPL si çdo vendim tjetër për rishqyrtim të ligjshmërisë. Për kundër që iu kemi drejtuar tre herë me shkrim ministrisë, deri dje nuk ka pasur përgjigje. Përgjigja ka ardhur dje, pasi është publikuar vendimi. Përgjigja e cila ka ardhur dje, është e mangët, potencohen 2 ligje të cilat bien në kundërshtim me njëra tjetrën, ndërkaq nuk na japin sqarim se, a duhet me rishqyrtuar vendimin apo jo?! Askund nuk ceket që të shfuqizohet ai vendim dhe çështja të kthehet në rishqyrtim. Për derisa një vendim është votuar, është publikuar, ka hyrë në fuqi, ai vendim donë zbatim, për deri sa nuk është kthyer nga ministria për rishqyrtim apo ndryshim plotësim. Ne tani jemi duke miratuar një propozim vendim të ri, pa e ndryshuar dhe plotësuar vendimin e vjetër.

**znj. Ardita Rrahmani:** Tani, a po e anulojmë vendimin e vjetër apo çka po bëjmë ?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nuk po e anulojmë vendimin e vjetër, ndërkaq unë mendoj se duhet anuluar vendimi i vjetër.

**z. Bahri Selimi:** Në mbledhjen e KPF keni kërkuar arsyetim shtesë, çka ka me u bërë me projektet e parapara me mjetet e mbetura të vitit 2021, pasi që kjo shumë e mjeteve nuk po bartet. Ne sot vetëm kemi ofruar sqarim shtesë, se nuk kemi të bëjmë me bartje të mjeteve. Nga shuma 814,000€ që është vendosur me i bartur sipas vendimit të mbledhjes së kaluar, ministria na ka thënë se vendimi nuk anulohet, por pjesërisht aprovohet, që i bien se mjetet e bartura të vitit 2022 kalojnë. Unë jam në kontakt çdo ditë me analistët duke u marrë, ata gati veç e kanë përfunduar këtë pjesën e vitit 2022. Vendimi mbetet i pandryshuar, ne sot nuk kemi bërë vendim për bartje të mjeteve. Kemi të bëjmë me shkak pasojë, sepse ky propozim vendim për transfer, ka ardhur nga shkaku se është refuzuar bartja e mjeteve të viti 2021.

**znj. Ardita Rrahmani:** Ju me këtë propozim vendim, iu keni dhënë prioritet nëntë (9) projekteve që kanë qenë të parapara me u realizuar me mjetet e bartura të vitit 2021.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Për me qartësuar, janë propozuar një pjesë e mjeteve që me i mbuluar projektet që i kemi paraparë me u realizuar me mjetet e bartura të vitit 2021. Unë po mendoj se po të ishte në rregull, se edhe ata nuk e kanë të qartë sa duhet këtë çështje, se ligji për financat thotë diçka tjetër, ndërkaq ligji për buxhetin e vitit 2023 thotë diçka tjetër, për me anashkaluar këto mjete që po thotë MF tani, se janë tejkaluar kufijtë buxhetor, në të cilët kufijtë buxhetor ka paraparë vetëm mjete të vitit 2022. Tash, për me qartësuar, se nuk jam financier, ministria thotë se në këtë rast nuk e keni shkelur ligjin që i keni bartur krejt mjete, por e keni shkelur ligjin, se i keni kaluar kufijtë buxhetor të miratuar me buxhetin e vitit 2023. Tani thotë se iu lejohet me i shpenzuar mjetet e vitit 2022, ndërkaq për mjetet e vitit 2021 ka me u marrë një vendim tjetër, ndoshta me ua lëshuar prapë komunave, por derisa të sqarojnë. Po të ishte në rregull, na kishin thënë se kemi të drejtën e bartjes së mjeteve të vitit 20022, ndërkaq ato të vitit 2021 jo.

**znj. Ardita Rrahmani:** Unë në këtë rast nuk e kam të qartë këtë çështje, ndoshta ju i keni të qarta drejtor, i potencuat sqarimet. Në mbledhjen e kaluar është marrë një vendim për

realizimin e 15 projekteve, ai vendim është në fuqi, ndërkaq sot në kuadër të atyre projekteve të cilave iu kemi dhënë prioritet, ju sot i kemi lënë 6 prej tyre, duke iu dhënë prioritet këtyre tjerave.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Unë qysh po e kuptoj, mjetet e mbetura të vitit 2022, lejohen me u shpenzuar në vitin 2023, ndërkaq mjetet e vitit 2021 nuk janë shfuqizuar, për momentin janë të pezulluara. Drejtori e ka sjellë propozim vendimin që pjesën e projekteve për të cilat janë pezulluar mjetet, për me mundur me mbuluar pjesërisht. Nëse qeveria i lejon mjetet e vitit 2021, ne përsëri ato mjete kemi me i bartur dhe destinuar diku. Për këto mjetet duhet me u marrë një vendim tjetër, pasi që me ligjin e buxhetit janë tejkaluar kufijtë buxhetor. Deputetët e KK është dashur me ngritur këtë çështje kur është miratuar buxheti i vitit 2023, e jo pasi që është vërejtur se është bërë tejkalim buxhetor, pasi që ligji për financat publike e thotë ndryshe, ndërkaq ligji i buxhetit 2023 i ka caktuar kufijtë buxhetor. Ne mund të diskutojmë por nuk jemi vendimmarrës. Çdo gjë që na vjen nga niveli qendror, ne duhet ta zbatojmë.

**z. Naim Beça:** Kur është aprovuar ai ligj dhe pse kemi vendosur ne në kundërshtim me atë ligj?
**Kryesuesi i Kuvendit:** Ligji i buxhetit për vitin 2023, është miratuar në dhjetor 2022. Ligji i financave publike në raport me financat, është ligj me i fortë se ligji i buxhetit, sepse ligji i buxhetit ndryshon. Ligji i financave lejon me u bartë mjetet, ndërkaq ai i buxhetit i ka të përcaktuar kufijtë buxhetor dhe nuk lejon bartjen e atyre mjeteve. Niveli qendror besoj se e rregullon këtë çështje, por për momentin është kjo situatë. Tani janë paraparë realizimi i këtyre projekteve, për me mbuluar këtë pjesën e mjeteve që nuk po na lejohet bartja e mjeteve.

**z. Rrustem Zenuni:** Lidhur me këtë pikë e cila është duke u diskutuar këtu, unë kërkoj nga ju kryesues, kryetari i komunës, drejtori i financave, që në bashkëpunim me Asociacionin e Komunave të Kosovës, me u angazhuar që kjo çështje të shkon në Gjykatën kushtetuese, sepse kompetencat vetanake janë kategori kushtetuese, mjetet janë nga të HVK të tatimit në pronë. Unë kërkoj që ne si KK, nëse nuk ka të interesuar nga komunat tjera, me iniciuar këtë lëndë në Gjykatën kushtetuese, se jemi palë të autorizuar, kemi të drejtë, komunat kanë të drejtë me i ngritur këto shqetësime në gjykatën kushtetuese.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nuk e di a e keni të qartë Rrustem, zyrtarja e KK tre herë iu ka drejtuar MAPL me shkrim për me sqaruar çështjen e vendimit. Nuk kemi pasur përgjigje, ndërkaq dje ka ardhur një përgjigje e pa konkretizuar. Të çështja e inicimit të lëndës në Gjykatën kushtetuese, ka shumë para neve që munden me iniciuar këtë çështje, janë anëtarët e Kuvendit të Kosovës, të cilët e kanë ngritur apo nuk e kanë ngritur dorën kur është trajtuar ky problem, janë Asociacioni i Komunave të Kosovës të cilët për çdo ditë e ngitini këtë çështje, edhe ne komunat jemi të fundit të cilët mundemi me ngritur këtë çështje. Kjo çështje nuk ka me mbetur pa zgjidhje, por është çështje e përkohshme, duhet të tejkalojmë këtë hendek të krijuar me këto mjete të bartura. Merret vendimi i KK, ne duhet të zbatojmë sido që merret, se vendimi i KK për ne është ligj. Për deri sa ata thonë se kemi me diskutuar çështjen e këtyre mjeteve dhe kemi me vendosur me ligj, ne nuk kemi ku me shkuar. Niveli qendror e nxjerrë ligjin, ne e zbatojmë ligjin, ndërkaq gjykata kushtetuese e vërteton se a jemi në harmoni me ligjin.

**z. Rrustem Zenuni:** Neve si nivel lokal na është cunguar kompetenca -e drejta jonë si komunë, kështu që nuk do të diskutoj me për këtë pikë.

**z. Qamil Stagova:** Desha me u lidhur me diskutimin e Agimit. Është e vërtetë se të kodi buxhetor, ndërtimi i urës mbi lumin nerodime dhe hekurudhë, janë hequr 5,000€, mirëpo kjo nuk ka të bëjë me urën e cila do të ndërtohet sivjet. Ajo është në kodin tjetër ku shkruan, ndërtimi i urave mbi lumin nerodime dhe mbi lumin lepenc. Për shkak të mungesës se mjeteve, është hequr njëra, dhe ka mbetur vetëm, ndërtimi i urës mbi lumin nerodime.

**z. Bahri Selimi:** Kur të merret vendimi për shpronësime, komuna e ka të drejtën brenda 3 viteve me kompensuar pronarin e pronës. Pasi ministria të bënë vlerësimin e pronës, ne shumën e vlerësuar të mjeteve, brenda 2 viteve duhet me kryer pagesën, kështu që kjo nuk është problem, se nuk rrezikohet asgjë.

**z. Agim Çaka:** Pajtohem edhe unë me Arditën dhe me disa prej kolegëve këtu. Mendoj se transferi i mjeteve është diçka e lejuar, drejtori e ka pasur parasysh që kjo është ligjore, mirëpo kjo ka të bëjë me planifikimin dhe menaxhimin e situatës. Në momentin kur nuk menaxhohen dhe planifikohen mirë, vijmë të kjo situatë, që na mbesin mjetet dhe ata të nivelit qendror e kanë miratuar ligjin dhe e lënë hapësirën ligjore kur nuk munden me u shpenzuar krejt mjetet, me u bartur dhe ransferuar. Në këtë kontest, unë e përkrahi këtë transfer të mjeteve, por në mënyrë që ato mjete me u shpenzuar si duhet. Këto dy ditë janë parë nja dy elemente të cilat kanë qarkulluar në portale, besoj se janë të sakta, që realizimin i të HVK të vitit 2022 ishte 78 apo 79% , besoj se janë të dhëna reale. Si përqindje me është dukur mirë, pasi kishte pasur komuna që kishin përqindje me të vogël të shpenzimeve. Kjo ka të bëjë me punën dhe përgjegjësinë e qeverisë komunale që janë duke i kryer punët dhe realizuar investimet kapitale si duhet. Informata tjetër, është qarkullimi vjetor sipas ATK. Këtu komuna e Kaçanikut gati se nuk figuronte fare. Për mua me e rëndësishme është qarkullimi vjetor sipas ATK sesa qarkullimi të realizimi i investimeve kapitale, sepse ne të realizimi i investimeve kapitale, mundemi me i mbuluar me letra, se kjo është aftësia e atyre që merren me këto punë, se duhet me qenë goxha mjeshtër i mirë me i rregulla këto çështje. D.m.th. sipas ATK, komuna jonë del komuna me e dobët me qarkullim vjetor, qe kjo i bien se a jemi duke punuar, a janë duke qarkulluar mjetet apo nuk jemi duke punuar diçka, ndërkaq të realizimi i IK del se jeni në rregull, keni marrë mjete keni investuar, në projekte kapitale, mirëpo ajo realisht duhet me reflektuar në qarkullimin vjetor sipas ATK, sepse nëse nuk ka qarkullim vjetor, kjo i bien se nuk jemi duke punuar si komunë. Kjo është shqetësuese me pasur qarkullim vjetor me tepër Hani i Elezit apo ndonjë komunë tjetër e vogël, se kjo po i bien se njerëzit e tonë janë duke shkuar atje duke bërë qarkullim.

**z. Bahri Selimi:** Ju po i referoheni statistikave të Institutit GAF, ku ne kemi realizuar 79%. Statistikat jo gjithmonë e paraqesin gjendjen reale, por të komuna jonë komplet 79% ka qenë në shpenzim në projekte përkatëse, ku kemi paguar vendime gjyqësore që kanë ndodhë nga vitet e mëhershme. Komuna e Ferizajt është me përqindje të realizimit 100%, është komunë që për formon mirë në shumë aspekte, por të kjo përqindja 100% të IK është se përmbaruesit i kanë marrë mjete nga obligimet e viteve të kaluara, se përformancën nuk e ka ashtu si e ka paraqitur në statistika. Komuna jonë, kam dashur me iu thënë, kur i sjellim propozim vendimet për transfere të mjeteve, deri në shtator kemi qenë shumë dobët në realizimin e IK. Falë vendimeve të miratuara nga ju për lëvizje të mjeteve, bënim transfere në projekte ku e shihnim të arsyeshme me shkuar mjetet, duke i hequr nga ndonjë projekt tjetër. Meritor për realizmin e kësaj përqindje jeni vet ju. Para 2-3 dite ne kemi marrë Raportin e auditimit për vitin e kaluar, ku përmendet përformancë tejet e mirë e komunës së Kaçanikut në realizim të buxhetit. Viti i kaluar, të gjithë e dimë se ka qenë vit bukur stagnues, ka komuna me përformancë shumë të ulët, ndërkaq të komuna jonë 80%, është shumë reale ku janë realizuar mjetet për IK. Në vitin 2020 ka ndodhur edhe neve me na u hequr mjetet për IK, por kanë qenë nga thesari, përmes rasteve në gjykatë dhe kanë shkuar në përmbarim. Mjetet janë marrë nga një projekt kapital, por lënda ka pasur të bëjë me shujtat në arsim- me pagat e arsimit, e kjo ka ndodhur të disa komuna që tani e kanë përqindjen shumë të lartë të realizimit, por nuk janë të gjitha realizim në IK, d.m.th. janë paguar obligimet e viteve të kaluara që nuk i përkasin kategorisë së IK. Në vitin 2022 komuna jonë nuk ka pasur raste të tilla, me i paguar obligimet në bazë të vendimeve të gjykatave të pagave në arsim, se i kemi paguar me herët, të cilat i kemi pas kryer në bazë të vendimeve për transfere dhe rialokime të cilat vendime i keni miratuar ju. Faleminderit edhe një herë, sikurse kjo pika tani për transfer e cila pres me u realizuar, që na i mundëson mos me i lënë mjetet pa shpenzuar, se tani e kemi frikën që të HVK, se ministria na ka bërë presion nga pak, kryesuesi me tha me herët se e keni një komoditet ju ekzekutivi që nuk i shpenzoni të

HVK sa duhet. Kjo është e vërtetë, për atë e kemi sjellë këtë propozimin me diskutua, pres miratimin e tij, për ridestinim të HVK në projekte kapitale, që me u shpenzuar mjetet.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe i njëjti u miratua me 15 votë Për, Kundër ishin 7 anëtarë nga LVV, Abstenuan 3 anëtarë nga LDK, dhe Raif Kasa nga LVV. Prezentë 26. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

**VENDIM**

**Për Transfer dhe Rialokim te mjeteve buxhetore / Lënda: 01Nr. 104/01-9164/23.**

**5**. Propozim Vendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e PK nr.00516-1 ZK Kaçanik, për rregullimin e rrugës dhe ndërtimin e urës mbi lumin nerodime;

**Kryesuesi i Kuvendit:** E hapi diskutimin:

**z. Agim Mani:** Të ky shpronësim që mendoni me u ndërtuar ura mbi lumin nerodime, ne mendojmë se është me interes publik nëse zgjerohet rruga të ETC. Me e rëndësishme është me u zgjeruar ura aktuale –ura e Hazirit dhe me u zgjeruar rruga, sesa me u ndërtuar rruga dhe ura, se rruga mbetet e ngushtë. Nëse doni me bërë zgjidhje njëherë e përgjithmonë se ajo rrugë e lidhë qytetin, shkollën, atëherë, pse nuk keni kërkuar me u zgjeruar komplet rruga prej urës, me u shpronësuar ajo pjesë deri të hekurudha. Kjo është zgjidhje që iu bëhet qytetarëve, se nëse ju tani e shpronësoni pjesën e paraparë, rruga mbetet e ngushtë dhe prapë ka me u kërkuar e njëjta, se ajo urë ka me ia rritur koston asaj rruge edhe me tepër. Mendimi im është, fillimisht me u zgjeruar rruga se është e ngushtë, këtë e kam vërtetuar vet kur kam kaluar atypari. Nëse nuk zgjerohet rruga, nuk na duhet as ura. Fillimisht duhet zgjeruar rruga, pastaj të ndërtohet ura apo të bëhet ndonjë kalkulim me i mirë.

**z. Selajdin Troni:** Edhe unë e përkrahi mendimin e parafolësit, sepse ajo rrugë ka shumë nevojë me u zgjeruar, se ka lëvizje të madhe në atë rrugë. Tani është edhe çështja e hekurudhës, kështu që do të ishte mirë të shqyrtohen mundësitë buxhetore për zgjerimit të asaj rruge deri të ajo ndalesa aty.

**z. Qamil Stagova:** Zakonisht për urat të cilat kanë qarkullim me shumë në mes të konstruksionit, nuk janë të përshtatshme. Rruga me e ngushtë është bash në atë pjesën e urës ekzistuese. Prej urës se re ku po mendohet, rruga vetëm zgjerohet, pasi të përfundon hekurudha e shohim sesa zgjerohet rruga. Nëse të ardhmen e shohim se ka pengesa, do t'i hyjmë ndonjë procedure të shpronësimit, nuk po e përjashtoj këtë çështje, mirëpo si zgjidhje, ndërtimi i urës është shumë i nevojshëm në atë pjesë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Edhe unë mendoj njëjtë si drejtori, kur të përfundon hekurudha, shihen edhe vijat edhe të rrugës edhe të hekurudhës. Ne këtu jemi, në të ardhmen mund të veprojmë për zgjerimin e rrugës.

**z. Naim Beça:** Pasi të përfundon hekurudha, kjo çështje mund të procedohet në rend pune në një mbledhje të KK, sepse tani nuk po i dimë shumë qartë ku kanë me u ndërtua ura.

**z. Qamil Stagova:** Unë nuk thashë për urë, por thashë për rrugë, nëse ka nevojë zgjerimi i rrugës, atëherë në një të ardhme mund të iniciojmë këtë çështje.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe i njëjti u miratua me 18 votë Për, Kundër ishin 5 anëtarë nga LVV, Abstenuan 3 anëtarë nga LVV. Prezentë 26. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

**VENDIM**

**Për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e PK nr.00516-1 ZK Kaçanik, në emër të Mevlude Dushkaja, për rregullimin e rrugës dhe ndërtimin e urës mbi lumin nerodime / Lënda: 01Nr. 104/02-9142/23.**

**6.** Propozim Vendimi për Shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesë të Parcelave kadastrale 00431-5, 00431-6, 00431-7; 00411-0 në ZK Duraj, për Këmbim me pronën komunale;

**Kryesuesi i Kuvendit:** E hapi diskutimin:

**z. Agim Mani:** Me këtë propozim vendim ne jemi duke folur për një projekt i cili ende nuk i ka bërë dy vite. Trotuari është shtruar në pronë të huaj, ndërkaq tani kërkohet këmbimi i pronës. Nuk është rasti i parë që janë këmbyer pronat, sepse ekzekutivi nuk i ka përfill projektet e detajuara, ku fillimisht caktohet baza, skica e projektit. Nuk na është ofruar dëshmi e mjaftueshme për këto parcela në këtë lokacion. Këtu thuhet së këmbimi i parcelës bëhet në 04315, 04316 dhe 04317, ndërkaq në fletë poseduese nuk ekzistojnë këto fare. Rruga e cila është rrugë publike, nga e dimë ne që është rrugë publike, por pa i pasur fletat poseduese me dëshmuar këtë, se prona me qenë pronë private e dikujt, kështu që duhet me pasur dëshmi- fletë poseduese që e vërteton se rruga është publike.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Janë të sqaruara në skica. Është propozim vendimi i propozuar nga DUKMM, i nënshkruar dhe vulosur

**z. Agim Mani:** Ne jemi duke folur për këmbim të parcelave, ndërkaq nuk kemi fleta poseduese. Në kadastër mund të figurojnë, por ne nuk kemi dëshmi se është rrugë publike kjo pronë. Nëse është ashtu si thoni, me gjeni ju numrin e parcelës 04315, ose 04316 dhe 04317. Nëse e sjellin fletën poseduese me vonë, munden me figuruar këto parcela në emër të dikujt tjetër, atëherë bëhet vonë. Kush jep përgjegjësi që kryetari e ka lëshuar tokën e huaj? Unë po pajtohem, vetëm po kërkoj dëshmi që prona është e këtij pronari, sepse nëse nuk është në të ardhmen mund të na dalin probleme.

**z. Rrustem Zenuni:** Trotuari ka pasur hapësirë me u ndërtuar në pronë të komunës, por kur është bërë zgjerimi i rrugës, se rruga është bërë shumë e kalueshme, ka lindur nevoja me i marrë aty 16m2. Kjo çështje është bërë me pëlqimin e komunitetit, se unë kam qenë prezent kur është nënshkruar marrëveshja, pastaj me u bërë këmbimi i pronave. Ne e dimë se përpara janë bërë rrugët e ngushta, me kaluar me qerre, tani po lind nevoja e zgjerimit të tyre. Unë një diçka po me habitë, ju jeni përfaqësues të qytetarëve, ndërkaq me dalë kundër kërkesave që janë në interes të qytetarëve, kjo nuk është në rregull. Unë po të isha në vendin e juaj, asnjëherë nuk do të isha kundër këtyre çështjeve. Tani këto çështje po kemi mundësi me vendosur, atëherë pse mos me i drejtuar këto çështje, pse ju pengon juve, unë nuk e di. Unë qysh në fillim të mandatit, kur ka lëndë të kësaj natyre, unë i mbështeti çdo kund ku ka këmbime, jo vetëm në f. Duraj. Unë jam i gatshëm me kërkuar nga DUKMM që në një mbledhje të KK me debatuar vetëm çështjen e këmbimit të pronave, qoftë edhe nëse janë 20 pikë, që me i rregulluar këto çështje njëherë e përgjithmonë. Pastaj, kushdo që vjen pas neve, mos të kenë probleme të kësaj natyre, sikur që ka pasur deri tani. Unë mendoj se kjo është një punë e mirë, e falënderojmë pronarin e pronës i cili ka shprehur gatishmëri me këmbyer pronën. Ka shumë pronarë që janë në gjendje me dhënë pronën e vet në këmbim me u rregulluar do çështje dhe ky vend me ecur përpara. Dinamika e jetës është bërë e madhe, kështu që është duke u kërkuar zgjerimi i rrugëve.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Të këto çështje, ne e dimë se qysh janë ndërtuar rrugët me herët, ndërkaq nuk është vonë nëse tani marrim veprime dhe i përmirësojmë. Pajtohem me Agimin që kërkon informata shtesë, se ato informata mund të ofrohen. Ndërkaq çështja pse nuk janë marrë veprimet me herët, ka qenë mirë me u bërë me herët, por tani me mirë është me i rregulluar sesa me i lënë në atë formë, kur ka vullnet të mirë se mundet mos me pasur vullnet dhe kërkon me rregulluar në procedurë gjyqësore.

**z. Naim Beça:** Të çështja e pronave, nga dita e parë që kam ardhur këtu, janë përmendur këto çështje. Unë po habitem me komunën, qysh mundet me shtruar një rrugë, kur prona është private!? Ne nuk jemi kundër këmbimit të pronave, por paraprakisht me i marrë veprimet e nevojshme, pastaj me sjellë në KK për miratim. Në lagjen time nuk shtrohet rruga në pronë

shoqërore, ndërkaq diku po shtrohen rrugë në prona private, pastaj lind nevoja me këmbyer parcelat me komunën, për faktin se keni njoftuesi në komunë dhe numrat në KK. Askush nuk është kundër me u shtrua rruga në pronë publike, por jo duke prekur prona private, se mjetet buxhetore janë të krejt qytetarëve të komunës, ndërkaq ju se pari po e shtroni rrugën se keni të njohshëm në komunë, pastaj e sjelli në KK se i keni numrat. Kjo për mua është e papranueshme dhe është një lloj patriotizmi lokal. E dyta, nga dita e parë keni kërkuar me qenë një TV në kuvend, për me i parë këto çështje se ku janë ato pika, me na shpjeguar si duhet këto çështje. Ndërkaq në këtë formë, ne mund të dalim disa të keq para qytetarëve, se po duhet me votuar kundër, sepse është shtruar ajo rrugë pa i marrë veprimet paraprake. Kjo të bënë me kuptuar se diçka nuk është në rregull këtu, se nuk shtrohen rruga ime që është në pronë publike, ndërkaq shtrohen rrugë duke prekur prona private, që pastaj me u rregulluar kjo çështje. Për mua kjo është e palogjikshme, sepse fillimisht duhet me i marrë veprimet paraprake, pastaj me u shtruar rruga dhe askush nuk është kundër, sepse kjo formë nuk është në rregull dhe është kundërligjore.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Naim, kur u shtrua kjo rrugë, Rrustemi ka qenë shumë i ri. E dyta, nuk është duke u shtruar rrugë private. Kjo është rrugë publike, ka lind nevojë me u zgjeruar një pjesë e cila gjatë ekzekutimit të punimeve, është parë se është e nevojshme. Nuk është asgjë që thatë ju se ka diçka prapa kësaj, por çështja është se ka lindur nevoja me u zgjeruar rruga.

**z. Naim Beça:** Unë nuk e kam fjalën vetëm për këtë rast, por për të gjitha rastet, edhe rastet e ardhme, pse komuna po i shtron rrugët, pa i kryer procedurat paraprake?

**z. Selajdin Troni:** Nuk është puna me fituar poenë politik në një lokacion të caktuar, por me u rregulluar çështjet, se nëse të duhet për poenë politik në një vend, të ndihmoj edhe unë. Çështja është me u rregulluar rrugët, se para 10 viteve nuk kanë qenë mundësia me i rregulluar me KK. Ne kemi pasur rast kur në Kovaçec e kemi zgjeruar një rrugë në lagjen Mezraja, ku e kanë lëshuar pronën. Qëllimi ka qenë me u rregulluar ajo rrugë, është rregulluar dhe sot ajo rrugë është funksionale.

**z. Naim Beça:** Mua nuk me ka ndihmuar askush, hajde e shikojmë rrugën në lagjen time.

**z. Rrustem Zenuni:** Ju rastin e patët edhe të pika paraprake, por nuk e votuat.

**z. Agim Çaka:** Të këto çështje, është mirë me pasur një pëlqim të komunitetit. Secili fshat e ka administratorin, këshillin e fshatit, dhe është mirë me pasur pëlqimin e atij këshilli dhe administratorit që i përfaqëson. E dyta, është mirë mos me pasur ndonjë ankesë. Në momentin që ka ankesa, edhe vetëm një ankesë nëse është, unë nuk e votoj. Ne nuk i dimë specifikat e fshatit, ne kemi përfaqësues të gjitha fshatrave, unë jam i prirur t'i besoj secilit këtu nga pjesa nga vjen, dhe kur e paraqet një problem, jam i prirur t'i besoj se është ashtu dhe nuk ka ndonjë interes personal aty. Çështja e planifikimeve, dinamika e jetës shpesh herë na bien në një situatë që me i bërë do ndryshime për shkak të rrethanave, mirëpo është mirë mos me pasur ndonjë keqpërdorim këtu apo interes personal. Dy kushtet të cilat i potencova nëse plotësohen: Pëlqimi i komuniteti dhe 2. Mos me pasur ankesa, unë jam me përkrahur këmbimin. Të pjesa tjetër që i përket drejtorit, si skicat etj. nëse drejtori ka bërë ndonjë gabim, është në përgjegjësi të tij, dhe nesër apo pas nesër mund të përballet me procedura gjyqësore, ne nuk kemi kurrfarë përgjegjësie aty.

**znj. Ardita Rrahmani:** Po nisem nga diskutimi i Rrustemit, pse nuk e kemi votuar vendimin. Nuk jeni ju polic me na u drejtuar neve, pse e keni votuar apo nuk e keni votuar vendimin. Ne i përfaqësojmë këtu subjektin tonë politik dhe qëndrimet e subjektit tonë dhe të qytetarëve, kështu që kjo pyetje nuk është korrekte nga ana e juaj me na u drejtuar, kur edhe ju edhe ne i përfaqësojmë interesat e qytetarëve. Unë në mbledhjen vijues të tregoj se çka ke votuar ti në interes të qytetarëve, ti përmendi edhe unë do pika. Tjetra, ne po flasim me i bërë do këmbime

të pronave, në rregull. Për lokalitetin nga jeni ju, nuk i di se për cilat prona po flitet dhe është e pamundur me i ditur nga janë ato rrugica, njëjtë sikurse ti që nuk e dinë nga janë në lagjen time. Po me intereson me ditur që nuk ka mëhallë në Kaçanik që rrugët janë të ngushta, pavarësisht shtëpia sa është e madhe, veturat i parkojnë përjashta, me çka është e pamundur me kaluar ai i fundit me pasur qasje në shtëpinë e tij. A duhet aty me bërë këmbim të pronave, por nuk ka çka me këmbyer?! Unë mundohem me shkuar në shtëpinë time me veturë, por nuk mundem me dalë nga parkimet në rrugë, a merret kush me këtë çështje? Ju jeni në këtë rast përfaqësues i pushtetit, unë jam i opozitës. Unë të adresoj këtë shqetësim, ndërkaq ju me ekzekutivin zgjidhni si ju mendoni. Në mëhallën time ka njerëz që e kanë votuar subjektin e juaj, dhe duhet me i rregulluar këto çështje, jo për hatrin tim, por për hatrin e atyre tjerëve, nëse po duhet me i shikuar ashtu qysh po thoni ju. Këtë urë në të ardhmen kanë me kaluar unë, vajza ime, prindi im, kështu ky pingpongu i votove nuk e votove, nuk qon shumë peshë, nuk ka fuqi.

**z. Rrustem Zenuni**: Unë pse iu thashë që nuk e keni votuar vendimin? Ju me siguri nuk me paske dëgjuar. Reagimi im është se ky këmbim është duke u bërë për nevoja të rrugës e jo për poenë politik. Unë për qytet atje ku e potencuat nevojën e këmbimit, nuk kam çka me u interesuar, kur nuk ka çka me këmbyer. Për çështjen e parkingjeve të veturave në rrugë, është policia për këtë punë, kështu që mundeni me thirrur policinë e jo mua.

Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u miratua me 17 votë Për, Kundër 7 nga LVV, Abstenoj Raif Kasa nga LVV. Prezentë 25. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

**VENDIM**

**Për Shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesë të Parcelave kadastrale 00431-5, 00431-6, 00431-7; 00411-0 në ZK Duraj, për Këmbim me pronën komunale / Lënda: 01Nr. 350/01-9205/23.**

**Kryesuesi i Kuvendit:** E konstatoj mbledhjen të përfunduar në ora 13:00. Deri në fund të mbledhjes qëndruan 25 anëtarë, pasi që Arlinda Rakoci Raka me lejen e kryesuesit shkoj gjatë shqyrtimit të pikës 2, ndërkaq Kadri Krivenjeva para se me u votuar pika e fundit.

| | |
|---|---|
| Procesmbajtëse | Kryesues i Kuvendit |
| Makfire Malsiu | Kemal Murseli |

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

KAÇANIKU

**Komuna Kaçanik**
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

**LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP**

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **REFERENCË:** | 01-104/02-11152/23 | | | | |
| **PËR/ZA/TO:** | **Kuvendin Komunal** | | | | |
| **CC:** | | | | | |
| **PËRMES/PREKO/THROUGH:** | **z. Besim Ilazi ,** Kryetari i Komunës | | | | |
| **NGA/OD/FROM:** | per Kryesuesi i Grupit Punues z. Xhelal Gashi | | | | |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | Propozim për miratim të Planit Komunal për Riintegrim të Personave të Riatëedhesuar dhe Integrimin e të Huajve 2023-2025 | | | | |
| Nr. i zyrës:<br>Br. kancelarije:<br>Room No.: | | Lokacioni:<br>Kucni:<br>Extension: | Administrata Komunale | Data:<br>Datum:<br>Date: | **12.05.2023** |
| PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION | | | | | ☒ |
| PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL | | | | | ☒ |
| SIPAS DISKUTIMIT/KAKOJE RASPRAVLJENO/AS DISCUSSED | | | | | ☐ |
| SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/AS REQUESTED | | | | | ☐ |
| SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN | | | | | ☐ |
| PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION | | | | | ☒ |
| **AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE** | | | | | |

Sipas vendimit nr prot 01.104/02-8824/23 të datës 13.04.2023 është themeluar Grupi punues për hartimin e planit Komunal Për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatëdhesuar Dhe Integrimin e të Huajve 2023-2025.

Grupi ka qenë i përbër nga 8 Zyrtarë të Administratës Komunale, 1 zyrtar i Zyrës së Punësimit Kaçanik, dhe Koordinatorit regjoinal për ri integrim të cilët e kanë përfunduar këtë draft plan.

Pas punës së vazhdueshme të grupit punues është hartuar ky draft propozim i këtij plani komunal dhe se të njejtin ia përcjellim Kyetarit të komunës, që i njeti plan ti përcillet Kuvendit për miratim

Me respekt.

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova**
**Republic of Kosovo**

KAÇANIKU

**Kuvendi i Komunës**
**Skupština Opština**
**Municipal Assambly**

**Kryetari i Komunës**
**01Nr.101/02-8824/2023**
**Kaçanik, 13. 04. 2023**

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të ligjit të Vetëqeverisjes Lokale si dhe në harmoni me Strategjinë për Migrim 2021-2025 të aprovuar nga Qeveria e Kosovës, rregulloren (QKR) Nr.22/2020 për Riintegrimin e personave te Riatëdhesuar si dhe bazuar në Rregulloren( QKR) Nr.09/2019 për integrimin e të huajve,si dhe statutin e Komunës Kryetari i Komunës merr këtë;

**V E N D I M**

Për formimin e grupit punues për hartimin e planit Komunal për ri integrim të qendrueshëm të personave të riatëdhesuar dhe Integrimin e të huajve në Komunën e Kaçanikut

Formohet grupi punues për hartimin e planit Komunal për ri integrim të qendrueshëm të personave të ri atëdhesuar dhe Integrimin e të huajve në Komunën e Kaçanikut 2023-2025 në përbërje prej :
1.Xhelal Gashi **QPS** , 2. Gafurr Guri **DA,** 3. Fadil Guri **ZKK,** 4. Eljesa Begunca **DSH|P,**
5. Hidajete Hoxha-Guri **Integrime Evropiane** 6. Vedat Dema **NjDNJ**
7. Arditë Shehu **Urbanizëm,** 8. Memet Mulaku **ZP,** 9.Driton Halili **MPB.**

1. Sipas pikës 1 të këtij vendimi, grupi punues obligohet që të ndërmerr të gjitha veprimet për hartimin e planit të cekur më lart për riintegrimin e personave të ri atëdhesuar dhe integrimin e të huajve për periudhë 2023-2025

2. Obligohen të gjitha drejtorit tjera brenda Komunës që ti ofrojn mbëtetje Grupit Punues.

3.Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës

E Punoi: F G
Iu dërgohet : Arkivit
Antarëve të Grupit punues
Kryetarit të Komunës

REPUBLIKA E KOSOVËS * KOMUNA E KAÇANIKUT * OPŠTINA KAČANIK * REPUBLIKA KOSOVA

**Kryetari i Komunës**
**z. Besim Ilazi**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova
Republic of Kosovo

**Komuna Kaçanik**
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

**DRAFT PLANI KOMUNAL PËR RI INTEGRIMIN E QËNDRUESHËM TË PERSONAVE TË RIATDHESUAR DHE INTEGRIMIN E TË HUAJVE NË KOMUNËN E KAÇANIKUT**

**2023 - 2025**

Duke u bazuar në nenin ....... të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale,
në harmoni Strategjinë për Migrim 2021 - 2025 të aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Rregulloren (QRK) Nr.22/2020 Për Riintegrimin e personave të Riatdhesuar si dhe bazuar në Rregulloren për Integrimin e të Huajve (Rregullore (QRK) Nr. 09/2019 për integrimin e të huajve është miratuar në mbledhjen e 110 te Qeverise së Kosovës, me vendimin nr. 01/110, date 11.07.2019) nenin .........të statutit të Komunës së Kaçanikut, Kuvendi i Komunës së Kaçanikut në mbledhjen e Mbajtur më _______________ 2023, aprovoi:

**Planin Komunal për Ri integrimin e Qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe Integrimit të të huajve në Komunën Kaçanik**
**2023 - 2025**

**Shkurtesat**

| | |
|---|---|
| ANP | Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës |
| APRK | Agjensioni i Punësimit i Republikës së Kosovës |
| AZHBR | Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural |
| BE | Bashkimi Evropian |
| DRPRIH | Departamenti për Ri integrim të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve |
| DKA | Drejtoria Komunale e Arsimit |
| EPPRM | Ekipi për Parandalim dhe Reagim për Mosbraktisje |
| KA | Komisioni për Ankesa |
| KASH | Korniza Afatmesme e Shpenzimeve |
| KKR | Komisioni Komunal për Ri integrim |
| MATP | Masat Aktive të Tregut të Punës |
| MAPL | Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal |
| MASHTI | Ministria e Arsimit, Shkencës,Teknologjisë dhe Inovacionit |
| MBPZHR | Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural |
| MPJD | Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës |
| MFPT | Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve |
| MKK | Ministria për Komunitete dhe Kthim |
| MMPHI | Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës |
| MPB | Ministria e Punëve të Brendshme |
| MSH | Ministria e Shëndetësisë |
| MSA | Marrëveshja e Stabilizim Asocimit |
| PR | Person i Riatdhesuar |
| PIR | Plani Individual i Ri integrimit |
| PII | Plani Individual i Integrimit |
| QAP | Qendrat e Aftësimit Profesional |
| QPS | Qendrat për Pune Sociale |
| SMR | Sistemi për Menaxhimin e Rasteve |
| ZKKK | Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim |
| ZP | Zyrat e Punësimit |
| ZGJC | Zyra e Gjendjes Civile |

**HYRJE**

Qeveria e Republikës së Kosovës e ka aprovuar Strategjinë për Mingrim 2021 - 2025, Rregulloren (QRK) Nr.22/2020 Për Riintegrimin e personave të Riatdhesuar si dhe bazuar në Rregulloren për Integrimin e të Huajve (Rregullore (QRK) Nr. 09/2019 për integrimin e të huajve është miratuar në mbledhjen e 110 te Qeverise së Kosovës, me vendimin nr. 01/110, date 11.07.2019).

Në kuadër të Agjendës Evropiane të Kosovës, kriteret nga Udhërrëfyesi për Liberalizimin e Vizave të përcaktuara në Bllokun 0, Ri pranimi dhe Ri integrimi tashmë janë përmbushur. Gjatë hartimit të Strategjisë për Ri integrim, janë adresuar të gjitha kërkesat që dalin nga Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së.

Strategjia e Ri integrimit ka për qëllim ri integrimin e qëndrueshëm socio-ekonomik të personave të riatdhesuar përmes avancimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të një sistemi efektiv e efikas të shërbimeve, të fokusuar në nevojat e të kthyerve.

Strategjia, si dokument qeveritar i politikave të ri integrimit është obligative të zbatohet në tëre territorin e Republikës së Kosovës. Në kuadër të Planit te Veprimit te Strategjisë është paraparë edhe hartimi i Planeve Komunale për Ri integrim të qëndrueshëm. Me qëllim të zbatimit të koordinuar në praktikë të Strategjisë për Migrim 2022 - 2025, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) në bashkëpunim me Drejtoritë Komunale si dhe me përfaqësuesit e organizatave vendore e ndërkombëtare, si Grupi Punues, kanë hartuar Planin Komunal për ri – integrim të qëndrueshëm dhe Integrimin e të huajve për Komunën e Kaçanikut.

Plani i Veprimit përmban objektivat, aktivitetet konkrete dhe masat për arritjen e objektivave, përcakton institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse për arritjen e secilit objektiv, saktëson kornizën kohore për realizimin e secilit aktivitet, koston e përafërt financiare për zhvillimin e aktiviteteve, indikatorët matës të objektivave dhe aktiviteteve dhe mjetet e verifikimit.

Plani është hartuar në bazë të Strategjisë për Mingrim 2021 – 2025, Rregulloren (QRK) Nr.22/2020 Për Riintegrimin e personave të Riatdhesuar si dhe bazuar në Rregulloren për Integrimin e të Huajve (Rregullore (QRK) Nr. 09/2019 për integrimin e të huajve është miratuar në mbledhjen e 110 te Qeverise së Kosovës, me vendimin nr. 01/110, datë 11.07.2019) dhe Planit të veprimit në nivel shtetëror, në bashkëpunim të ngushtë me MPB/DRPRIH si institucion përgjegjës për ri integrim në nivel nacional, dhe në vete ngërthen strukturën e saj, mirëpo duke pasur parasysh se ka të bëjë me nevojat e personave të riatdhesuar në Komunën e Kaçanikut, përmban edhe aktivitetet specifike për vetë komunën dhe është e bazuar në të dhënat e siguruara nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim. Kështu, ne këtë Plan është mundësuar integrimi maksimal i gjitha aktiviteteve për arritjen e ri integrimit të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në komunën e Kaçanikut.

## Plani Komunal i Veprimit për riintegrimin dhe integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe të huaj 2023-2025

| *Objektivi 1:* | *Indikatorët për matjen e arritjes së objektivit* | *Baza* | *Caku 2023* | *2025* |
|---|---|---|---|---|
| ***Avancimi i sistemit të ri integrimit për personat e riatdhesuar, duke aplikuar qasjen e orientuar në nevojat specifike për riintegrimin e personave te riatdhesuar dhe integrimin e të huajve*** | • *Janë identifikuar nevojat e grupeve të cenueshme dhe shërbimet ofrohen bazuar në planin individual të riintegrimit dhe te integrimit;* | *40%* | *60%* | *80%* |
| | • *Shërbimet e riintegrimit dhe integrimit monitorohen sistematikisht dhe ndërmerren masat e nevojshme përmirësuese;* | *50%* | *70%* | *80%* |
| | • *Është arritur riintegrimi dhe i integrimit qëndrueshëm socio ekonomik i grupeve të cenueshme;* | *30%* | *50%* | *70%* |

| # | Masa | *Veprimet* | *Indikatorët* | *Institucioni përgjegjës* | *Institucioni /partneri përkrahës* | *Kosto financiare* | *Afati kohor* | *Mjetet e verifikimit* |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *1.1* | Identifikimi i nevojave të grupeve të cenueshme; | 1. Realizimi i vizitave në familjet e kthyera, apo të posa ardhurve të huaj brenda 72 orëve pas kthimit, apo pas marrjes së statusit/leje qëndrimit në Kosovë, bashkërisht me përfaqësuesin e DRPRIH dhe QPS;<br><br>2. Intervisto familjen dhe plotëso formularin e Vlerësimit të Nevojave; | NR. i familjeve të cenueshme të kthyera, dhe të huaja në komunë<br><br>Nr. vizitave të realizuara nga ekipi për VN<br><br>Nr. i FVN të plotësuar<br><br>Nr. i formularëve të vendosur në SMR | ZKKK<br>DRPRIH/MPB | QPS<br>DRPRIH/MPB<br>Specialist shëndetësor<br>Policia në komunitet - (Sipas nevojës)<br><br>Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë | KA | Në vazhdimësi | Raportet nga tereni<br><br>FVN i Plotësuar dhe nënshkruar nga palët<br><br>SMR |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 3. Vendos FVN të skanuar në SMR | | | | | | |
| 1.2 | Hartimi i planit individual të ri integrimit dhe integrimit, bazuar në pakot standarde të shërbimeve dhe nevojat e identifikuara ne FVN; | Harto Planin Individual të ri integrimit dhe integrimit për secilin person dhe familje të cenueshme, në bashkëpunim të ngushtë me drejtoritë përkatëse komunale;<br><br>Vendose PIR/PII të skanuar në SMR; | Nr. i Planeve Individuale të ri integrimit dhe integrimit, të hartuara; | ZKKK<br>DRPRIH/MPB | QPS<br>ZP<br>Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë | KA | Në vazhdimësi | Planet Individuale të ri integrimit dhe integrimit në SMR |
| 1.3 | Zbatimi i planit individual të ri integrimit dhe integrimit përmes ofrimit i shërbimeve të ri integrimit të qëndrueshëm për grupet e cenueshme; | Këshillo personin e riatdhesuar dhe të huajin për parashtrim të kërkesave dhe informoje për afatet ligjore te parashtrimit te kërkesave;<br><br>Ndihmo PR në plotësimin e kërkesave dhe dokumentacionit;<br><br>Bashkëpuno me drejtoritë përkatëse komunale për sigurimin e shërbimeve të nevojshme;<br><br>Regjistro kërkesat dhe përfitimet në | Nr. i kërkesave te parashtruara, bazuar në PIR;<br><br>Nr. dhe llojet e skemave të mbështetjes;<br><br>Nr. i kërkesave dhe përfitimeve të regjistruara ne SMR; | ZKKK<br>DRPRIH/MPB | Drejtoritë komunale përkatëse<br><br>DRPRIH/MPB<br>ZP<br>QAP<br><br>Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë | BRK - Buxheti i ri integrimit dhe integrimit | Në vazhdimësi | Raportet e rregullta<br><br>Kërkesat e parashtruara<br><br>SMR |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | SMR; | | | | | | |
| 1.4 | Monitorimi dhe vlerësimi periodik i ri integrimit dhe integrimit të qëndrueshëm për grupet e cenueshme; | Monitoro në baza mujore zbatimin e PIR;<br><br>Vlerëso në baza tremujore skemat e ofruara, ndikimin e tyre dhe nevojat për plotësime apo ndryshime të skemave për arritjen e ri integrimit të qëndrueshëm dhe integrimit; | Nr. i raporteve mujore të monitorimeve dhe vlerësimeve;<br><br>Raporti tremujor i vlerësimit të ndikimit te skemave të ri integrimit dhe integrimit, me rekomandimet konkrete për masa shtesë, në rast nevoje; | ZKKK<br>DRPRIH/MPB | Drejtoritë komunale përkatëse<br>ZP<br>Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë | KA | Në vazhdimësi | Raportet e tremujore të monitorimit dhe vlerësimit |
| 1.5 | Vlerësimi përfundimtar i ri integrimit dhe integrimit dhe mbyllja e rastit; | Vlerëso gjendjen përfundimtare dhe nivelin e ri integrimit dhe integrimit te PR sipas PIR;<br><br>Mbylle rastin në dokumentacion fizik;<br><br>Mbyll rastin në SMR- konstato - ri integrim / integrim i qëndrueshëm; | Nr. i raporteve të vlerësimit përfundimtar për secilin person/familje;<br><br>Numri i rasteve të mbyllura në dosje fizike;<br><br>Numri i rasteve të mbyllura në dosje fizike SMR | ZKKK | DRPRIH/MPB<br>ZP<br>Drejtoritë komunale përkatëse<br>Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë | KA | Në vazhdimësi | Raportet e mbylljes së rasteve pas 18 muajve;<br><br>Dosjet fizike të PR, të mbyllura<br><br>SMR |

| **Objektivi specifik: 2** | ***Indikatorët për matjen e arritjes së objektivit*** | ***Baza*** | ***Caku 2023*** | ***2025*** |
|---|---|---|---|---|
| ***Avancimi i sistemit të referimit të rasteve në skemat adekuate të ri integrimit të personave të riatdhesuar dhe integrimit të të huajve*** | • *Sistemi i referimit dhe koordinimit ndërmjet akterëve komunal është i vendosur dhe funksional;* | *40 %* | *70%* | *90%* |
| | • *Numri i rasteve të referuara tek autoritetet relevante komunale, bazuar në profilin e tyre është rritur;* | *40 %* | *75%* | *90%* |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | • *Rritet numri i drejtorive komunale të ndërlidhura me SMR* | | | *30 %* | *60 %* | *80 %* |
| **#** | ***Masa*** | ***Veprimet*** | ***Indikatorët*** | ***Institucioni përgjegjës*** | ***Institucioni /partneri përkrahës*** | ***Kosto financiare*** | ***Afati kohor*** | ***Mjetet e verifikimit*** |
| 2.1 | Vendosja e një sistemi funksional të referimit dhe koordinimit ndërmjet akterëve komunal; | Koordino ndihmën dhe mbështetjen me drejtoritë relevante komunale, ne baza ditore, për secilin rast;<br><br>Realizo takime te rregullta dhe takime ad-hoc, diskuto rastet që kërkojnë zgjidhje; | Nr. i rasteve të referuara ne drejtorit përkatëse komunale;<br><br>Nr. i takimeve te rregullta dhe numri i rasteve te diskutuara;<br><br>Nr. i takimeve ad –hoc dhe numri i rasteve te diskutuara; | ZKKK<br>DRPRIH/MPB | DRPRIH/MPB<br>MAPL<br>MFPT<br>MSH<br>MBPZHR<br>QPS<br>ZP<br>Drejtoritë komunale përkatëse<br>Qendra e Shëndetit mendor<br>Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Kosovë | KA | Në vazhdimësi | SMR<br><br>Raportet e rregullta nga tereni<br><br>Raportet e rregullta nga DRPRIH/MPB<br>ZKKK |
| 2.2 | Profilizimi i të riatdhesuarve dhe të huajve, vlerësimi i nevojave pas arritjes në komuna; | Pranimi në zyrë i personave të riatdhesuar apo të huaj;<br><br>Intervisto të riatdhesuarin/të huajin, parashtro pyetje rreth nevojave dhe mundësive të | Nr. i personave të lajmëruar në ZKKK;<br><br>Nr. i personave të intervistuar;<br><br>Nr. i dosjeve me profilin personave të riatdhesuar dhe te huaj; | ZKKK<br>DRPRIH/MPB | DRPRIH/MPB<br>ZP<br>Drejtoritë përkatëse komunale | KA | Në vazhdimësi | Raportet e DRPRIH/MPB<br>ZKKK<br>SMR |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | tij/saj;<br><br>Krijo profilin e secilit person të kthyer apo te huaj;<br><br>Vlerëso dhe evidento nevojat e tij/saj;<br><br>Vendos profilin dhe nevojat në SMR; | Nr. i personave me nevojat e vlerësuara;<br><br>Nr. i personave me profilin e vendosur ne SMR | | | | | |
| 2.3 | Referimi i personave të riatdhesuar dhe të huajve tek autoritetet relevante komunale bazuar në nevojat dhe profilin e tyre; | Refero personat në drejtoritë përkatëse për marrjen e shërbimeve p.sh:<br>Refero në ZGJC personat qe kanë nevojë për dokumentacion civil;<br><br>Refero personat e kthyer, apo të huaj në ZP që të regjistrohen si punëkërkues;<br><br>Refero personat e kthyer apo të huaj të cenueshëm në QPS;<br><br>Refero në DKA personat e kthyer apo të huaj që kanë fëmije për informim dhe asistimin e tyre për regjistrimin e tyre në shkolla; | Nr.i personave të referuar në drejtoritë përkatëse;<br><br>Nr .i personave te referuar në ZGJC;<br><br>Nr.i personave te referuar në ZP;<br><br>Nr.i personave te referuar në QPS;<br><br>Nr.i personave te referuar në DKA; | ZKKK | DRPRIH<br>ZP<br>QPS<br>QAP<br>Drejtoritë komunale përkatëse<br>Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë | KA | Në vazhdimësi | Raportet e DRPRIH/MPB<br>ZKKK<br><br>SMR |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.4 | Përmirësimi i sistemit të këshillimit të personave të riatdhesuar apo të huaj pas arritjes në komunë; | Bazuar në profilin dhe nevojat, këshillo ata për mundësitë e përfitimit nga shërbimet publike dhe skemat e ri integrimit dhe të integrimit;<br><br>Këshillo dhe oriento ata se cilat dokumente ju nevojiten për çfarë shërbimi;<br><br>Ndihmo ne përgatitjen dhe kompletimin e kërkesave;<br><br>Këshillo për respektimin e afateve dhe detyrimet ligjore;<br><br>Njofto ata për pasojat ligjore të ri emigrimit; | Nr. i personave të këshilluar nga ZKKK<br><br>Nr. i personave qe janë ndihmuar për përgatitjen dhe kompletimin e dokumenteve | ZKKK | DRPRIH/MPB<br>QPS<br>ZP<br>ZP<br>QAP<br>Drejtoritë përkatëse komunale<br>Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë | KA | Në vazhdimësi | Raportet e DRPRIH/MPB<br>ZKKK<br><br>SMR |
| 2.5 | Ndërmarrja e masave me akterët relevant për gjurmim, referim dhe këshillim të personave të riatdhesuar dhe të huaj; | Vendos sistem të bashkëpunimit të rregullt me Policinë në komunitet, me grupet në komunitet, me shkollat, organizatat;<br><br>Kërko që të | Takimet e rregullta me akterët relevant<br><br>Numri i të riatdhesuarve | ZKKK | DRPRIH<br>Policia e Kosovës<br>Shkollat<br>ZP<br>Drejtoritë komunale përkatëse<br>Organizatat | / | Në vazhdimësi | Raportet e DRPRIH/MPB<br>ZKKK<br><br>Numri i të riatdhesuarve dhe te huajve të identifikuar |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | informohesh nëse ndonjë person apo familje është kthyer/ apo person apo familje e huaj ka marre statusin e mbrojtjes ndërkombëtare apo leje qëndrim, e nuk është identifikuar në SMR dhe/apo nuk është lajmëruar në zyrën tuaj;<br><br>Kontakto personin e kthyer apo te huajin informo për mundësitë e mbështetjes, refero në institucionet përkatëse; | dhe te te huajve që identifikohen si rezultat i këtij bashkëpunimi | | vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë | | | |
| 2.6 | Monitorimi dhe vlerësimi i sistemit të referimit dhe koordinimit; | Realizo takime te rregullta me ZKKK;<br><br>Diskutoni për referimin dhe koordinimin e rasteve;<br><br>Analizo sistemin e referimit dhe koordinimit;<br><br>Vlerëso gjendjen aktuale dhe Rekomando masa përmirësuese, në rast nevoje; | Nr. i takimeve të rregullta | ZKKK<br>DRPRIH/MPB | ZP<br>Drejtoritë komunale përkatëse<br><br>Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë | / | Në vazhdimësi | Raportet monitoruese |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.7 | Referimi i rasteve pas periudhes 12 mujore sipas legjislacionit në fuqi. | Identifikimi i personave / familjeve qe kane nevoje per mbeshtetje pas 12 muajve.<br><br>Ndërmarrja e veprimeve për planifikim buxhetor për vazhdimin e akomodimit dhe masave tjera te nevojshme pas 12 muajve. | Vizita personave / familjeve në skemën e akomodimit dhe me nevoja specifike pas periudhes 12 mujore<br><br>Takime dhe informim për rastet me drejtoritë përgjegjëse në mënyrë që të bëhet planifikimi buxhetor | ZKKK<br>QPS<br>Drejtoritë përgjegjëse | DRPRIH<br>ZP | / | Në vazhdimësi | Raporte të rregullta |

| Objektivi specifik 3 | *Indikatorët për matjen e arritjes së objektivit* | *Baza* | *Caku 2023* | *2025* |
|---|---|---|---|---|
| ***Avancimi i masave të ri integrimit dhe integrimit të qëndrueshëm ekonomik*** | • *Numri i punëkërkuesve të riatdhesuar apo te huaj të profilizuar dhe të këshilluar për zhvillimin në karrierë;*<br>• *Numri i të riatdhesuarve/huajve të punësuar;*<br>• *Numri i përfitueseve të vetëpunësimit dhe shërbimeve të konsulencës;*<br>• *Numri i përfituesve nga skemat e aftësimit profesional;*<br>• *Numri i të riatdhesuarve/te huajve përfitues të grandeve bujqësore dhe këshillimeve në fushën e bujqësisë;*<br>• *Numri i të riatdhesuarve/te huajve të mbështetur nga komuna me material dhe mjete bujqësore;* | *60%* | *70%* | *90%* |

| | | | • *Zgjerimi i fushave të aftësimit profesional në përputhje me nevojat e tregut* | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *%* | ***Masat*** | ***Veprimet*** | ***Indikatorët*** | ***Institucioni përgjegjës*** | ***Institucioni /partneri përkrahës*** | ***Kosto financiare*** | ***Afati kohor*** | ***Mjetet e verifikimit*** |
| 3.1 | Regjistrimi i të riatdhesuarve/të huajve si punëkërkues në Zyrat e Punësimit; | Prano në zyrë personin e riatdhesuar/të huaj;<br>Regjistro personat e riatdhesuar/te huaj si punëkërkues;<br><br>Informo ata për të drejtat e tyre dhe mundësitë e mbështetjes me MATP;<br><br>Informo ata për mundësitë e tyre në baze të legjislacionit në fuqi; | Nr. i personave të riatdhesuar apo te huaj të regjistruar si punëkërkues; | APRK<br>ZP | DRPRIH/MPB<br>ZKKK<br>QAP<br>Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë | / | Në vazhdimësi | Raportet e ZP<br>Raportet e ZKK |
| 3.2 | Profilizimi dhe këshillimi për zhvillim në karrierë i punëkërkueseve të riatdhesuarve apo te të huajve; | Intervisto atë, parashtro pyetje rreth mundësive dhe nevojave të tij/saj;<br><br>Vlerëso dhe evidento nevojat e tij/saj<br>Krijo profilin e secilit person të kthyer apo të huaj<br><br>Këshillo ata për orientim ne karriera, bazuar ne aftësitë dhe mundësit e tyre | Numri i personave të riatdhesuar, te huaj të cilëve u janë vlerësuar nevojat e tij/saj;<br><br>Nr i dosjeve fizike të personave të riatdhesuar apo te huaj që janë këshilluar në ZP dhe nevojat e tyre jane evidentuar;<br><br>Numri i të riatdhesuarve apo te huajve punëkërkues ku janë | ZP | ZKKK<br>QAP | / | Në vazhdimësi | Raportet e ZP<br>Numri i dosjeve<br>Shënimët dhe raportet nga SMR |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Krijo një dosje për secilin person te riatdhesuar apo te huaj<br><br>Vendos shënimet në SMR | vendosur shënimët për profilizim dhë këshillim në SMR | | | | | |
| 3.3 | Punësimi i të riatdhesuarve apo te huajve përmes ndërmjetësimit në punësim; | Ndërmjetëso në punësim personat e riatdhesuar apo ata te huaj të përgatitur për tregun e punës;<br><br>Evidento të dhënat relevante në SMR; | Numri i rasteve të ndërmjetësuara<br><br>Numri i rasteve të punësimit të riatdhesuarve apo te te huajve me ndërmjetësim<br><br>Të dhënat për ndërmjetësim dhe punësim në SMR | ZP | DRPRIH<br>ZKKK<br>APRK<br>Bizneset<br>Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë (donatoret) | / | Në vazhdimësi | Raportet e ZP me të dhënat mbi numrin e rasteve të ndërmjetësimit dhe punësimit të personave të riatdhesuar apo atyre te huaj |
| 3.4 | Trajnimi në punë dhe punësimi i të riatdhesuarve apo te te huajve përmes subvencionimit të pagës; | Ndërmjetëso për trajnim përmes punës personat ne nevojë për përgatitjen për tregun e punës;<br><br>Monitoro mbarëvajtjen e trajnimit dhe punësimit; | Numri i rasteve të ndërmjetësuara për trajnim dhe përgaditje për tregun e punës;<br><br>Numri i rasteve të monitoruara | ZP<br>QAP | DRPRIH<br>ZKKK<br>Bizneset<br>Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë | / | Në vazhdimësi | Raportet e ZP dhe QAP |
| 3.5 | Vetëpunësimi i të riatdhesuarve apo te të huajve përmes financimit të planeve të biznesit; | Informo këta persona për mundësitë dhe kushtet e përfitimit nga kjo skemë;<br><br>Informo keta persona | Numri i të riatdhesuarve apo te te huajve që informohen për mundësitë dhe kushte e përfitimit përmes planeve të biznesit | ZP | DRPRIH<br>ZKKK<br>QAP<br><br>Organizatat vendore dhe | / | Në vazhdimësi | Raportet e ZKKK |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | kur thirrja të jetë e hapur për aplikim;<br><br>Ndihmo këta persona në kompletimin e dosjes për aplikim; | | | ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë | | | |
| 3.6 | Aftësimi profesional i personave të riatdhesuar dhe te te huajve në përputhje me kërkesat e tregut të punës; | Identifiko personat e riatdhesuar dhe te huaj që kanë nevojë për aftësim profesional;<br><br>Identifiko profilin e tyre dhe orientoj ata ne profesionet adekuate me prirjet dhe dëshirat e tyre;<br><br>Referoj ata në QAP përkatëse; | Numri i të riatdhesuarve apo te huajve që vijojnë aftësimin profesional<br><br>Numri i të riatdhesuarve apo te huajve të profilizuar dhe orientuar për AP<br><br>Numri i të riatdhesuarve apo te huajve që referohen në QAP | ZP<br>QAP | DRPRIH<br>ZKKK<br>Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë<br>Bizneset | / | Në vazhdimësi | Raportet e ZP me të dhënat e të riatdhesuarve dhe të huajve që vijojnë aftësimin profesional |
| 3.7 | Monitorimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm i zbatimit të Masave Aktive të Tregut të Punës (MATP); | Monitoro në baza të rregulltambarëvajtjen e Masave Aktive të Tregut të Punës (MATP);<br><br>Vlerëso ndikimin e tyre ne përgatitjen dhe ri integrimin e PR; | Numri i të riatdhesuarve de te huajve që përfitojnë nga MATP ;<br><br>Të dhëna për ndikimin e MATP në riintegrimin dhe integrimin e tyre | ZP<br>DRPRIH/MPB<br>(Koordinatori Rajonal) | ZKKK<br>APRK<br>Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë | / | Në vazhdimësi | Raportet periodike te monitorimit dhe vlerësimit të përgatitura nga DRPRIH/MPB<br>(Koordinatori Rajonal) |
| 3.8 | Mbështetja me grante, mjete dhe materiale bujqësore, trajnimi dhe këshillimi i të | Informimi i të ketyre personave për mundësitë e përfitimit të granteve bujqësore; | Numri i të riadhesuarve dhe te huajve që kanë përfituar grante bujqësore | Drejtorati i Bujqësisë dhe Zhvillimit rural/ Komuna | ZKKK<br>AZHBR/MBZHR<br>Drejtoritë përkatëse komunale | / | Në vazhdimësi | Raportet e ZKKK me të dhënat për rastet kur përfitues të granteve janë personat e |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | riatdhesuarve dhe te huajve në zonat rurale; | Përfshirja e të riatdhesuarve dhe te huajve si përfitues i granteve bujqësore; | | | Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë | | | riatdhesuar |

| Objektivi specifik 4 | Indikatorët për matjen e arritjes së objektivit | Baza | Caku 2023 | 2025 |
|---|---|---|---|---|
| ***Avancimi i sistemit për ri integrim dhe integrim të mirëqenjës sociale të personave të riatdhesuar dhe te huajve*** | *Numri i të riatdhesuarve dhe te huajve të pajisur me dokumentacionin e nevojshëm për përfitim nga shërbimet sociale;* | *40 %* | *75%* | *90%* |
| | *Numri i të riatdhesuarve dhe te huajve përfitues të asistencës sociale;* | *50%* | *70%* | *90%* |
| | *Numri i personave të riatdhesuar dhe personave te huaj në nevoje që kanë pranuar trajtim psiko-social;* | *%* | *30%* | *50%* |
| | *Numri i personave të riatdhesuar dhe personave te huaj të përfshirë në aktivitetet kulturore, sociale, rekreative dhe inovative ;* | *10 %* | *30%* | *60%* |
| | *Numri i të riatdhesuarve dhe te te huajve që u është siguruar banim i qëndrueshëm nga komunat (pas periudhës 12 mujore);* | *10%* | *30%* | *50%* |
| | *Numri i të riatdhesuarve dhe te te huajve që kanë përfituar asistencë në sigurimin e kushteve për banim;* | *30%* | *50%* | *60%* |

| # | *Masa* | *Veprimet* | *Indikatorët* | *Institucioni përgjegjës* | *Institucioni /partneri përkrahës* | *Kosto financiare* | *Afatet kohore* | *Mjetet e verifikimit* |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4.1 | Informimi dhe këshillimi social i personave të riatdhesuar dhe te huajve për mundësitë e përfshirjes në skemat sociale;; | Prano në zyre personin e riatdhesuar apo te huaj, te referuar nga ZKKK;<br><br>Informo atë për shërbimet dhe | Numri i të riatdhesuarve dhe te huajve që u ofrohet këshillë për shërbimet dhe skemat sociale;<br><br>Numri i rasteve që monitorohen derisa | QPS | ZKKK<br>DRPRIH/MPB<br>(Koordinatori Rajonal)<br>ZP<br>Drejtoritë përkatëse komunale<br>Organizatat | / | Në vazhdimësi | Raportet nga QPS<br>Raportet e ZKKK |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | skemat sociale;<br><br>Këshilloje atë për procedurat dhe dokumentet e nevojshme për përfshirje sociale;<br><br>Menaxho rastin deri ne vendosjen ne sistemin social;<br><br>Regjistroi ne bazën e te dhenave (SNS) rastin/skemën e përfitimi; | vendosen në sistemin social<br><br>Vendosja e të dhënave për të riatdhesuarit dhe te huajt që përfitojnë nga skemat sociale në SMR | | veKKRndore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë | | | |
| 4.2 | Asistimi i personave të riatdhesuar dhe te huaj në sigurimin e dokumentacionit të nevojshëm. | Të përfshihet zyra e gjendjës civile si pjesë e KKR-së.<br><br>Asisto personat e riatdhesuar dhe personat e huaj për sigurimin e dokumenteve te nevojshme për aplikim skemat sociale si dhe ndihma juridike falas<br><br>Menaxho dhe monitoro rastin në shqyrtimin e kërkesës dhe vendimin përfundimtar;<br><br>Regjistroi ne SMR | Vendimi i KKR-së plotësuar dhe ndryshuar nga komuna<br><br>Numri i personave të riatdhesuar dhe te huajve që asistohen për përgaditje të dokumentacionit për aplikim në skemat sociale dhe ndihme juridike falas<br><br>Numri i rasteve të monitoruara deri në shqyrtim të kërkesës deri te vendimi përfundimtar<br><br>Vendosja e të dhënave për numrin e të riatdhesuarve dhe te huajve që | Komuna<br>KKR<br>QPS | ZKKK<br>DRPRIH/MPB<br>(Koordinatori Rajonal)<br>ZP<br>Drejtoritë përkatëse komunale<br>Agjensioni për ndihmë juridike falas | / | Në vazhdimësi | Raportet nga QPS<br>Raportet e ZKKK |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | rastin/skemën e përfitimit; | përfitojnë nga skemat sociale në SMR | | | | | |
| 4.3 | Sigurimi i banimit të qëndrueshëm | Monitoro rastet që janë të akomoduar me qera nga programi i ri integrimit dhe i integrimit<br><br>Këshillo dhe ndihmo rastet ne nevojë për aplikim për banim social<br><br>Siguro banim të qëndrueshëm pas skadimit te qirasë<br><br>Regjistro në SMR rastin e përfitimit | Numri i rasteve të monitoruara<br><br>Numri i rasteve të asistuara për aplikim për banim social<br><br>Numri i rasteve që u sigurohet banim i qëndrueshëm<br><br>Të dhënat në SMR | ZKKK<br>DRPRIH/MPB<br>(Koordinatori Rajonal) | QPS<br>Drejtoritë përkatëse komunale<br>Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë | / | Në vazhdimësi | Raportet e ZKKK për numrin e të riatdhesuarve që kanë përfituar banim të qëndrueshëm |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4.4 | Trajtimi psikologjik dhe asistenca psiko-sociale për personat e riatdhesuar dhe te huaj në nevojë; | Identifikimi i rasteve dhe vlerësimi i nevojave për trajtim psiko-social<br><br>Ofrimi i ndimës psiko-sociale për personat e identifikuar<br><br>Monitorimi i rasteve që u ofrohet ndihmë psiko sociale<br><br>Regjistrimi i të dhënave për rastet dhe formën e ndihmës psiko-sociale për personat e riatdhesuar dhe te te huajve<br><br>Sigurimi i transportit për trajtim | Numri i rasteve të identifikuara në nevojë për ndihmë psiko-sociale<br><br>Numri i rasteve që marrin ndihmë psiko sociale<br><br>Numri i rasteve të monitoruara<br><br>Numri i rasteve dhe të dhënave të regjisturuara në SMR | ZKKK<br>QPS | Qendra e shëndetit mendor<br>Shkollat<br>Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë | / | Në vazhdimësi | Raportet e ZKKK për numrin e te riatdhesuarve që janë mbështetur dhe formën e ndihmës psiko sociale<br><br>Raportet e Organizatave vendore dhe ndërkombëtare |
| 4.5 | Sigurimi i kushteve të banimit përmes renovimit, rindërtimit dhe mobilimit te shtëpive të personave të riatdhesuar dhe te huaj; | Këshillo personat e riatdhesuar dhe te huajt për mundësit e përfitimit nga skema e renovimit, rindërtimit dhe mobilimit të shtëpive<br><br>Ndihmo ata në kompletimin e dosjes për aplikim ne këto skema | Numri i personave të riatdhesuar dhe te huaj që janë informuar dhe asistuar për mundësitë e përfitimit nga skema e renovimit, ndërtimit dhe mobilimit të shtëpive;<br><br>Numri i rasteve/dosjeve të proceduara për shqyrtim në KKR;<br><br>Numri i vendimeve të | KKR | ZKKK<br>DRPRIH/MPB<br>MMPHI<br>Drejtoritë përkatëse komunale<br>Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë | / | Në vazhdimësi | Raportet e ZKKK<br>Raportet e DRPRIH<br><br>Të dhënat nga SMR |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Procedo dosjet për shqyrtim nga KKR<br><br>Përcjelle lënden për ekzekutim ne DRPRIH përmes koordinatorit rajonal<br><br>Regjistro rastin dhe vendos dosjen ne SMR | KKR për këtë skemë;<br>Numri irasteve të përcjella në DRPRIH për ekzekutim;<br><br>Vendosja e të dhënave në SMR për numrin e rasteve të aplikimit dhe vendimeve përfundimtare të përfitimit nga kjo skemë. | | | | | |
| 4.6 | Përfshirja (Informimi) e të kthyerve dhe te huajve në aktivitetet kulturore, sociale, rekreative dhe inovative; | Informo dhe përfshij personat e riatdhesuar dhe te huaj në aktivitete kulturore, sociale, rekreative dhe inovative, te organizuara ne komunën tuaj<br><br>Bashkëpuno me organizatat për realizim te aktiviteteve te tilla ne komunën tuaj | Të dhënat mbi informimin e të riatdhesuarve dhe te huajve për përfshirje në aktivitete sociale dhe kulturore në nivel komunal<br><br>Të dhënat mbi bashkëpunimin me organizata dhe projekte me qëllim përfshirjen e të riatdhesuarvedhe te huajve në aktivitete të ndryshme | ZKKK | DRPRIH/MPB<br>Drejtoritë përkatëse komunale<br>Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë<br>Mediat | / | Në vazhdimësi | Raportet e ZKKK |

| Objektivi specifik 5 | *Indikatorët për matjen e arritjes së objektivit* | *Baza* | *Caku 2023* | *2025* |
|---|---|---|---|---|
| ***Përfshirja e fëmijëve të riatdhesuar dhe te huajve në të sistemin edukativo arsimos*** | *Numri i nxënësve të riatdhesuar dhe te huaj të përfshirë në nivelin përkatëse të shkollimit;* | *90%* | *100%* | *100%* |
| | *Numri i nxënësve që kanë vijuar kurset e gjuhës dhe mësimin plotësues;* | *50%* | *60%* | *85%* |
| | *Numri i rasteve të reagimeve të ekipeve për parandalim dhe reagim kundër braktisjes;* | *50%* | *75%* | *80%* |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | *Numri i programeve mësimore të rishikuara të shpërndara në shkolla;*<br><br>*Numrin i të rriturve të riatdhesuar dhe te huaj, që kanë mësuar shkrim- lexim;*<br><br>*Numri i raporteve të monitorimit dhe vlerësimit të përfshirjes në mësim;* | | | *10%*<br><br>*50%*<br><br>*80%* | *50%*<br><br>*60%*<br><br>*85%* | *80%*<br><br>*70%*<br><br>*97%* |
| **#** | ***Masa*** | ***Veprimet*** | ***Indikatorët*** | ***Institucioni përgjegjës*** | ***Institucioni /partneri përkrahës*** | ***Kosto financiare*** | ***Afatet kohore*** | ***Mjetet e verifikimit*** |
| 5.1 | Përfshirja e fëmijëve të riatdhesuar dhe te huaj në nivelin përkatës të shkollimit; | Merr infromatat nga ZKKK për fëmijët e riatdhesuar dhe te huaj që duhet të përfshihen në sistemin arsimor<br><br>Vlerëso nivelin e njohurive te nxënësit te riatdhesuar dhe atyre te huaj<br><br>Përcakto nivelin përkatës te shkollimit<br><br>Akomodo nxënësit në klasat përkatëse | Numri i fëmijëve të riatdhesuar dhe atyre te huaj që janë përfshirë në sistemin arsimor<br><br>Raportet e vlerësimit të nevojave arsimore të fëmijëve të riatdhesuar dhe te huaj<br><br>Raportet e regjistrimit të nxënësve të riatdhesuar dhe te huaj | DKA<br>Shkollat | DRPRIH/MPB<br>ZKKK<br>QPS<br>Shkollat<br>Qendrat Mësimore<br>Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë | / | Në vazhdimësi | Raportet nga DKA<br>Raportet nga ZKKK |
| 5.2 | Organizimi i kurseve të gjuhës dhe mësimit plotësues për fëmijët e riatdhesuar dhe te huaj; | Identifiko nxënësit që kanë vështirësi në përdorimin e gjuhëve zyrtare<br><br>Organizo kurse të gjuhës në shkollën ne të cilën nxënësit vijojnë mësimin; | Numri i nxënësve te kthyer ne komune;<br><br>Numri i nxënësve të identifikuar me vështirësi ne përdorimin e gjuhëve zyrtare<br><br>Numri i nxënësve që | DKA<br>Shkolla përkatëse | DRPRIH/MPB<br>ZKKK<br>Shkollat<br>Qendrat Mësimore<br>Organizatat vendore dhe ndërkombëtare | / | Në vazhdimësi | Testet vlerësuese dhe raportet përkatëse |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Organizo mësimin plotësues bazuar në nevojat e nxënësit | kanë vijuar kurset dhe mësimin plotësues | | me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë | | | |
| 5.3 | Nostrifikimi i dokumenteve te nxënësve te riatdhesuar dhe te huaj; | Nostrifiko dokumentet shkollore të nxënësve të kthyer dhe te huaj<br><br>Ofro ndihmë në përkthim dhe verifikim të dokumentacionit të nevojshëm për nostrifikim | Numri i nxënësve që kanë nostrifikuar dokumente<br><br>Numri i rasteve që u është ofruar ndihmë në përkthim dhe verifikim të dokumenteve | DKA<br>MASHTI | DRPRIH/MPB<br>Shkolla përkatëse<br>Qendrat Mësimore<br>Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë | / | Në vazhdimësi | Raportete e DKA për rastet e nostrifikimit të dokumenteve |
| 5.4 | Funksionalizimi dhe fuqizimi i ekipeve për parandalim dhe reagim kundër braktisjes se shkollave nga fëmijët e riatdhesuar dhe te huaj; | Organizo takime të rregullta me ekipet për parandalim dhe reagim kundër braktisjes se shkollave<br><br>Diskuto për gjendjen e fëmijëve te riatdhesuar dhe te huaj, identifiko fëmijët ne rrezik për braktisje te shkollës<br><br>Ndërmerr masa konkrete ne bashkëpunim me prindërit dhe shkollën për parandalim te kësaj dukurie | Numri i takimeve të rregullta të ekipit për parandalim dhe reagim kundër braktisjes se shkollave nga fëmijët e riatdhesuar dhe te huaj<br><br>Të dhënat për aktivitetet dhe bashkëpunimin me prindër dhe akterët tjerë | Shkollat<br>DKA | KKR<br>ZKKK<br>Qendrat Mësimore<br>Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë | / | Në vazhdimësi | Raprotet nga Shkolalt dhe DKA |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Përgatit raporte të rregullta dhe ndaj ato me MASHTI dhe DRPRIH | | | | | | |
